

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7673 E hënë 8 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Analiza** **Ditës**

**Një zhvillim real brenda përm-bajtjes së rendit botëror, ka e-videntuar disa probleme të mprehta, shqetësime reale e pikëpyetje të naty-shme. Këto zhvillime...**

*Vijon në faqen 19*

**Nga VASIL KURETA**

**SHBA-Kinë vetëm luftë tregtare?**



**Opinion** **Ditës**

**Kam kohë që kam dashur të shkruaj diçka për gratë e shkrimtarëve dhe artistëve që kam njohur në vite, qysh nga rinia ime...Të shkruaj diçka për to, në përkujtim të tyre...**

*Vijon në faqen 20*

**Nga SULEJMAN MATO**

**Cilat ishin ato, gratë e shkrimtarëve dhe artistëve?**



Deputeti: Nuk bojkotojmë zgjedhjet, po shohim kandidatët

## Edi Paloka: Rama rrëzohet me dhunë, popullin s'e bëjmë "mish për top"

Nënkryetari i Kuvendit: Hapat e parë që do të ndërmarrim sapo opozita të vijë në pushtet

Nga VALENTINA MADANI

Edi Paloka, nënkryetar i PD-së akuzon kryeministrin Edi Rama se ka bërë pakt me krimin, ndaj shprehet i sigurt se ai mund të rrëzohet vetëm përmes dhunës. Por sipas tij, kjo nuk do të thotë që opozita do të bëjë popullin "mish për top" siç bëri Edi Rama...

Në faqet 4-5

## AKSIDENT I RENDE NE SURREL HUMB JETEN 38-VJEÇARI FLORENC VISHKURTI

# PERGJAKEN RRUGET, VDESIN DY TE RINJ

Ngjarje e rëndë edhe në Lushnjë, shuhet 35-vjeçarja Durra. Në Përrenjas përplasen me makinë 4 gjyqtarë futbollit, FSHF shtyn ndeshjen



(Në foto) Nderhyrja e zjarrfikëve për të nxjerrë nga makina të aksidentuarit, dje në Surrel. Vendi ku ndodhi ngjarja

### VIZITA NE SKRAPAR

**Beteja e Tendës së Qyqit, Presidenti Meta: Dimri i fundit i pushtesveve**

Në faqen 2

### VRASJA NE BLOK

**Lihen 1 muaj në burg Ervis Martinaj dhe shoku i tij Eljon Hate, avokatët: S'ka fakte**

Në faqet 6-7

### INTERVISTA

**Opozita braktis Këshillin Bashkiak, Halimi: Po diskutojmë djegien e mandateve**

Në faqen 9

### KESHILLAT

**Ëndrra amerikane, ambasada: Kujdes, ja ku duhet ta plotësoni aplikimin tuaj**

Në faqen 17

### KANCERI I GJIRIT, SHENJAT E TRAJTIMI



**Ylli Merja: Si të kuroni mykun me bimë mjekësore. Përdorni rignonin e mushmollën**

*Siplement*

Zbulohet dokumenti i rrallë ku gjeneral-major, Rexhep Kolli informon Hysni Kapon

## Dalin pseudonimet për Peshkopinë: "Besniku", "Rubiku", "Lisi" ...

"S'janë ndjekur përpunimet ndaj Zija Tafçiu, Jaruk Salihut, Xhedvdet Hunës e Qazim Strazimirit"

Nga DASHNOR KALOÇI

Nisur edhe nga pozita gjeografike që kishte rrethi i Peshkopisë në veri-lindje të vendit, duke pasur një brez të gjatë të vijës kufitare me shtetin fqinj të ish-Jugosllavisë, edhe vëmendja e Ministrisë së Punëve të Brendshme



**EKSKLUZIVE**

...dhe Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit ishte shumë më e madhe nga rrethet e tjera të vendit që nuk mbartnin atë problematikë që kishin rrethet kufitare. Veç të tjerash kjo gjë bëhet e ditur edhe nga një sërë dokumentesh arkivore me siglën "Tepër Sekret"...

Në faqet 10-11

## QEVERISJA AKUZAT

Valentina Madani

Kreu i PD: Me antimafian, askush nuk do ta gëzojë pasurinë e vënë me korrupsion

# Basha zbardh skemën: Rama dha 252 milionë euro për miqtë e tij

"Si grabiten paratë dhe pasuritë publike nga oligarkët"

Kryetari i opozitës Lulzim Basha publikoi dje një videomesazh, sipas të cilit tregohet mënyra se si vidhen dhe grabiten paratë dhe pasuritë publike nga kryeministri Rama dhe ata që PD-ja i quan oligarkë. Sipas Bashës, format më të përdorura të abuzimit janë: Licencimi pak ditë para tenderit; Kriteret përjashtuese; Kualifikime të padrejta; Regjistrimi offshore; Propozime të pakërkëtuara. Kreu i opozitës paralajmëron se me ligjin antimafia askush nuk do ta gëzojë pasurinë e vendosur me korrupsion. Verifikimi i tenderëve është pjesë e paketës së propozuar nga opozita për çlirimin e ekonomisë nga korrupsioni dhe oligarkia. PD ka llogaritur se prej ardhjes në pushtet, qeveria e Edi Ramës ka tenderuar 2.7 miliardë euro. Në një postim në rrjetet sociale, kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha shprehet se, prej ardhjes në pushtet, qeveria e Edi Ramës ka tenderuar 2.7 miliardë euro. Basha publikoi edhe një video ku sipas tij tregohet se abuzimi me tenderët ndahet në 3 zëra kryesorë: 900 milionë euro ose 1 në 3 tenderë zhvillohet pa garë. 753 milionë euro kanë shkruar për fasada dhe luks. 252 milionë euro për klientët, miqtë dhe familjen e Edi Ramës". Më pas, Basha rendit 5 prej formave më të përdorura të abuzimit me tenderet, sipas tij, gjatë qeverisjes së Edi Ramës në këto 5 vjet. "Licencimi i kompanisë fituese pak ditë përpara tenderit; Kriteret përjashtuese për të favorizuar një kompani të caktuar; Skualifikimet e padrejta të kompanive; Regjistrimi offshore i kompanive fituese; Propozime të pakërkëtuara kundër interesit publik". Sipas kreu të PD, mesazhi kryesor i paketës kundër korrupsionit dhe oligarkisë, është se ligji i ri antimafia do të bëjë të mundur që askush nuk do ta gëzojë pasurinë e vënë me korrupsion. Kreu i PD-së Lulzim Basha solli në vëmendje pikat kryesore të platformës së opozitës për të luftuar korrupsionin dhe për t'i kthyer qytetarëve çdo pasuri që i është marrë nëpërmjet korrupsionit. Në videon e shpërndarë nga kreu i opozitës në 'FB' renditen të parat masat "antimafia", nëpërmjet të cilave verifikohet, sekuestrohet, konfiskohet: pasuria e kompanive private dhe pronarëve të tyre, pasuria e zyrtarëve publikë që verifikohet se kanë abuzuar me detyrën, pasuria e personave të afërt me pronarin e kompanisë apo



Kryetari i opozitës Lulzim Basha

### LSI, VASILI: LUFTË PA KOMPROMIS KRIMIT QEVERITAR

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI, Petrit Vasili renditi dje 10 karakteristikë që sipas tij janë të Rilindjes. Vasili shkruan se dekalogu i mafies së vërtetë, është shteti i Rilindjes. "Lufta pa asnjë kompromis dhe me çdo mjet kundër një shteti të tillë, që shtyn shqiptarët drejt greminës së sigurte është legjitime, jetike, e pandalshme dhe pa kthim pas", shkruan z. Vasili. Sipas tij: "Rilindja nuk është ajo, që qeveris në asnjë moment punët e shtetit, por mafia qeveris shtetin dhe pushtetin. Rilindja krijon përditë në parlament alibitë ligjore për legjitimimin e mafies në shtet dhe në pushtet. Rilindja ndërton buxhetin e shtetit si një portë gjigande nga hyn dhe del para e mafies, si vjedhje tenderësh, koncesione gjithfarësh, përvetësim prona publikë etj. etj.."

zyrtarin. Qëllimi i paketës antimafia është: Goditja e korrupsionit dhe abuzimit me pushtetin; mbrojtja e pasurisë publike; garantimi i konkurrencës së lirë. Në videon mesazhin e kreu të opozitës sqarohet edhe një pikë tjetër e rëndësishme e

### PAA: Përfaqësim në çdo këshill bashkiak

## Zgjedhjet vendore, Duka: Do t'i kërkojmë Bashës një bashki

Agron Duka, kryetar i Partisë Agrare Ambientaliste, do t'i kërkojë kreu të PD-së Lulzim Bashës si kryetar i koalicionit opozitar, t'i besojë përzgjedhjen e kandidatit në një prej 61 bashkive të vendit, për zgjedhjet e ardhshme vendore! "Ne synojmë të kemi deri dy anëtarë në këshillin bashkiak, do të negociojmë në ndonjë bashki ku ne kemi struktura të mira të mund të kemi kandidatët tanë të përbashkët", u shpreh kreu i PAA-së. Sipas Dukës, këtë praktikë PD duhet ta ndjekë me të gjithë partitë aleate që kërkojnë të nxjerrin një kandidat, pasi sipas tij kjo do të forconte koalicionin

paqetës, çfarë verifikon antimafia: Kontratat PPP; Kontratat e koncesionit; Kontratat e Prokurimit Publik; Kontratat e tjetërsimit të pasurive publike; Aktet për lejit, licencat, autorizimet për shfrytëzimin e pasurive publike. Efektet e ligjit antimafia



**LUÇIANO BOÇI**  
Deputeti i PD, Luçiano Boçi, në Facebook' ironizoi dje Policinë e Shtetit. Boçi shkruan se policia tashme merret dhe me ndërtim, duke postuar disa foto ku shihet një makinë me targa policie që transporton zhavorr.

e dhe do të jepte efekte pozitive në zgjedhje. "Që të gjitha partitë që tentojnë të kenë kandidatë për bashki, sigurisht jo të nivelit të parë, kjo i bashkon akoma më tepër dhe do të jetë më rezultative për zgjedhjet vendore", theksoi aleati i PD-së. Por veç kandidatit për një bashki, ku PAA ka struktura të for-

ta, Duka u shpreh se synimi në zgjedhjet lokale është përfaqësimi në çdo këshill bashkiak! Kryetari i Partisë Agrare Ambientaliste ishte në Vlorë për nisjen e fushatës së re të anëtarësimeve dhe riorganizimit e strukturave për zgjedhjet vendore të vitit 2019.

konfiskuar përdoret për shërbime dhe investime publike". Lideri i opozitës theksoi mesazhin kryesor të paketës kundër korrupsionit dhe oligarkisë se ligji i ri antimafia do të bëjë të mundur që askush nuk do ta gëzojë pasurinë e vënë me korrupsion.

### Kryeministri Rama në Vlorë: Mbjatëm tre premtimet

Kryeministri Rama u rikthye dje në shtëpinë e Niko Ahmetit në fshatin Vajzë në Vlorë, të cilën e vizitoi pak javë më parë dhe i premtoi që do ta ndihmonte. Rama duke parë gjendjen e rëndë ekonomike u shpreh se do t'i rindëronte shtëpinë, do t'i mundësonte që të kishte energji elektrike në shtëpi, gjithashtu, u tha femijëve të Niko Ahmetit se do u plotësonte dëshirën për të vazhduar një shkollë profesionale. Rama tregoi se këto premtime i ka mbajtur, pasi shtëpia po ndërtohet dhe femijët kanë po studiojnë në shkollën që dëshironin.



Gjatë një seance parlamentare



**Beteja e Tendës së Qyqit, Meta: Dimri i fundit i pushtuesve**

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, u rikthye dje vendlindje, në Skrapar. Ai shkruan në 'Fb' se së bashku me kreu e Bashkisë së qytetit rivendosiën pllakën përkujtimore me emrat e 17 heronjve të rënë në betejën e Tendës së Qyqit. "Kjo betejë e jashtëzakonshme deri në ndeshje trup me trup përfundoi me humbjen poshtërore të pushtuesve falë gjakut të derdhur në betejë të partizanëve të Brigadës së parë Sulmuese dhe Grupit të Skraparit që u drejtua trimërisht nga Zylfytar Veleshnja. Kjo betejë pati një vlerë të madhe morale e psikologjike pasi tregoi se ai nuk ishte dimri i fundit i partizanëve, por i pushtuesve. Të gjithë të përkujdesemi në shumë për monumentet e luftës dhe të dëshmorëve tanë", shkruan Meta. Po dje Meta postoi një foto nga Prishtina, ku edhe takoi një person mjaft të veçantë. Meta shprehet se e ka mbajtur flajën për të vizituar Nënë Bajamen, e cila sipas tij me sakrificë pa fund ka rritur tre femijë të mbarë e të edukuar për të cilët është krenar. Në postimin e tij, Meta e falënderoi nënë Bajamen për mikpritjen e bujarinë e pa fund ashtu siç dinë nënat e Skraparit.





Taulant Balla i përgjigjet opozitës për përjashtimin: Çuat një kamion me baltë në PE!

# Takimi në Bruksel, PD-Ruçit: Largo Ballën nga delegacioni në PE

"I papërshtatshëm, për shkak të lidhjeve me krimin"

Valentina Madani

Opozita i dërgoi dje një kërkesë Kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, ku i kërkon largimin e Taulant Ballës nga Delegacioni Parlamentar i Stabilizim Asociimit. Opozita kërkon largimin e Taulant Ballës nga Delegacioni Parlamentar i Stabilizim Asociimit: Shoqërohet me trafikantë droge dhe mbron përdhunues me pushtet. Kërkesa e PD-së vjen një javë para mbledhjes së radhës së Komisionit të Përbashkët të Stabilizim-Asociimit që do të mbahet në Bruksel, ndaj deputetët e opozitës i kërkojnë kryeparlamentarit Ruçi të zëvendësojë kryetarin e komisionit Taulant Balla me një tjetër përfaqësues të maxhorancës. Në letërën e firmosur nga 5 anëtarët opozitarë të Komisionit thuhet se Balla është i papërshtatshëm për të mbajtur këtë detyrë për shkak të lidhjeve të tij me krimin. Letra është firmosur nga anëtarët e opozitës në delegacion, Genc Pollo, Albana Vokshi, Klajda Gjoshja, Jorida Tabaku, Aldo Bumçi dhe Oerd Bylykbashi. "Ne besojmë se jemi i informuar për lidhjen shoqërore e familjare të deputetit Taulant Balla me shtetasin Edmond Bego, i dënuar me 21 vite burg nga gjykatat italiane për trafik droge", thuhet në letërën e demokratëve. Në letër po ashtu përmendet edhe dëshmia e ish-officerit Nuhu, sipas të cilit Balla dhe deputeti Rraja kanë qenë të pranishëm kur punonjësi i policisë u kërcënua me armë në Komisaratin e Fushë-Krujës. "Edhe burime e prova të tjera duket se konfirmojnë kallëzimin e znj Maloku dhe deklarimet e nënkomisarisit Emiliano Nuhu përkundrejt mohimit nga deputeti Balla se ka qenë pjesë e kësaj ngjarje, thuhet në letërën dërguar z. Ruçi. Mbledhja e radhës e Komisionit të Përbashkët të Stabilizim-Asociimit është lajmëruar për të hënë e 15 tetorit. Përpara kësaj date, Gramoz Ruçi duhet t'i japë përgjigje kërkesës së opozitës, që pa e paragjykuar nuk pritet të sjellë ndonjë surprizë.



Sekretari i Përgjithshëm i PS-së, Taulant Balla

**MBLEDHJA**

Mbledhja e radhës e Komisionit të Përbashkët të Stabilizim-Asociimit është lajmëruar për të hënë e 15 tetorit. Përpara kësaj date, Gramoz Ruçi duhet t'i japë përgjigje kërkesës së opozitës, që pa e paragjykuar nuk pritet të sjellë ndonjë surprizë.

**ERVIN SALIANJI**

"Për të mbuluar përfshirjet e tua, Taulant, Ramës do i duheshin 5 vjet, jo 5 muaj, si në rastin e vëllait Agron, për të falsifikuar e prishur provat. Ti nga "furra" jote për 6 ditë nxore tabulate telefonike "të skaduar", por ato nuk bindin dot as miqtë e tu të krimin! Sot është dita për të thënë, nuk keni parë gjë akoma...." shprehet Saliiani.



"Emërimi, nga ministri që i vidhen eurot në shtëpi"

## Berisha: I shkarkuari për korrupsion emërohet sekretar i PS-së

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje se ish-drejtori i ALUIZNI-t në Sarandë i shkarkuar për korrupsion është emëruar sekretar organizativ në Partinë Socialiste lokale atje. "Para tre muajve, më dt 6 korrik drejtori i ALUIZNI-t Sarandë shkarkohet për korrupsion dhe dërgohet për ndjekje penale. Dy ditë më parë, Kallam Dëshatku me të dërguarit e tij, Taulant Bego/Jaris dhe ministri që çdo tre muaj i thejnë shtëpinë dhe i vjedhin thasët me euro, e emërojnë sekretar organizativ të Partisë Socialiste për Sarandën. Vetëm para tre muajsh e shkarkuan dhe e kallëzuan penalisht, ndërsa dje e emëruan sekretar partie?", shkruan Berisha në Facebook. Më tej ai publikon mesazhin e qytetarit dixhital: "Partia Socialiste Sarandë në prani edhe të Taulant Ballës dhe Damian Gjicknurit mbledhi asamblenë e saj ku zgjodhi (emëroi, në fakt) sekretariatit. Sekretar Organizativ zgjodhi Mariel Muratin, ish - drejtor i ALUIZNI-t Sarandë i pushuar dhe kallzuar penalisht nga ministria Etilda Gjonal më 6 korrik, pra tre muaj përpara, e deklaruar kjo masë ekstreme publikisht në konferencë shtypi nga zonia ministre. Pa u tharë akoma boja e shkarkimit dhe e kallëzimit nga Njësia Antikorrupsion, Balla dhe Gjicknuri e emërojnë sekretar organizativ. Ky është morali i "Bandës".

## "Qeveria është në funksion të bandave"

# Kryemadhi: Rruga e vetme, përballja sy më sy me regjimin e Ramës

Në turin e takimeve me strukturat e partisë, nga Kuçova, kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi apeloj shqiptarët që të ngrihen kundër regjimit të Edi Ramës. Ajo konfirmoi idenë se opozita nuk mund të marrë pjesë në parlament vetëm si fasadë. Rruga e opozitës sipas Kryemadhit është përballja me këtë regjim. "Tashmë ne si opozitë që të bëhemi alibi e Edi Ramës në parlament nuk ka më asnjë vlerë, që të jemi thjesht një mburojë që të themi ka demokraci, se ja opozita është në parlament, bën sikur flet, ne bëjmë sikur i dëgjojmë dhe ngremë forcën e kartonit dhe votojmë. Rruga e opozitës tashmë është vetëm një. Përballja sy për



**DEKLARATA**

"Opozita në parlament nuk ka asnjë vlerë, tani rruga e saj është përballja sy për sy me krimin",-u shpreh kryetarja e LSI-së në takimin me strukturat e LSI-së në Kuçovë.

sy me këtë regjim kriminal",-deklaroi znj.Kryemadhi. Kryetarja e LSI akuzoi se kjo qeveri është në funksion të bandave duke shkelur ligjin. "Ne nuk kemi nevojë për një politikë që punon dhe iu shërben bandave për të shkelur ligjin dhe për t'i mbrojtur ata dhe një politikë që përdoret si kamxhik ndaj qytetarëve, të cilët nuk kanë asnjë lloj

përkrahje",-u shpreh znj. Kryemadhi. I pranishëm në këtë takim ishte dhe deputeti Nasip Naço, i cili akuzoi maxhorancën se tjetërsoi qëllimin e reformës në drejtësi duke u mohuar shqiptarëve mundësinë për të qenë të gjithë të barabartë përpara ligjit dhe duke vënë në kontroll institucionet e reja të drejtësisë.

vlerësion si një argument për të bojkotuar takimin në Bruksel. Sa i takon akuzave ai i cilëson si prodhime filmike të dështuara të studios PD dhe kunati. "Filmi tjetër me nënkomisarin që u kërcënua në praninë time me armë në komisaratin, është drejt dështimit të plotë sepse jetojmë në kohën dixhitale dhe ka qeliza telefonike e kamera që i nxjerrin bloop dylbitë e Palokës. Po ndërkohë kjo baltë seriale është ende e vlefshme për eksport se miqtë e huaj s'kanë kohë të merren me detajet e këtyre manipulimeve të ndyra. Kështu edhe në Parlamentin Europian, bazuar tërësisht mbi shpifje, sapo u çua një kamion me baltë për të më mbuluar mua në sytë e partnerëve tanë. Hallin tim s'e kam fare se kam vite që përplasem pa kompromis me këtë lloj droge pres edhe më keq se kaq! Po a e meriton Shqipëria këtë baltoje të vazhdueshme? Ua lë shqiptarëve ta gjykojnë", shprehet z.Balla. Më herët në asamblenë socialiste në Sarandë, sekretari i Përgjithshëm i PS Taulant Balla i kërkoj opozitës t'i japë fund bojkotit. "Dua t'i them nga

Saranda opozitës, se javën e ardhshme kemi njoftuar thirrjen e një trezë politike të të gjitha partive parlamentare dhe jo parlamentare në funksion të përfundimit të reformës zgjedhore, për adresimin e të gjithë rekomandimeve të OSBE/ODHIR të transpozuar në amendamente të kodit zgjedhor. Opozita duhet të kuptojë që e vetmja rrugë për të qenë funksionale në demokraci është të marrë pjesë në Kuvend, të ndërpresë bojkotin dhe të gjithë së bashku të votojmë reformën zgjedhore",-tha z.Balla.

## AKSIONI I OPOZITES

### INTERVISTA

Valentina Madani

Nënkryetari i Kuvendit: Hapat e parë që do të ndërmarrim sapo opozita të vijë në pushtet

# Paloka: Rama rrëzohet me dhunë, por popullin së bëjmë "mish për top"

## "S'bëjmë 21 janar, por ngremë njerëzit kundër krimit"

**E**hi Paloka, nënkryetari i PD-së akuzon kryeministrin Edi Rama se ka bërë pakt me krimin, ndaj shprehet i sigurtë se ai mund të rrëzohet vetëm përmes dhunës. Por sipas tij, kjo nuk do të thotë që opozita do të bëjë popullin "mish për top" siç bëri Edi Rama me 21 janar. Por pavarësisht kësaj, z.Paloka thotë për "Gazeta Shqiptare" se opozita po përgatit terrenin për zgjedhje të lira dhe të barabarta. Ai përmend se PD ka paraqitur propozimet për rikthimin në rrugën e kushtetutshmërisë të reformës në drejtësi, ndryshimet kushtetuese për vetingun në politikë, platformën kundër korrupsionit dhe lidhjeve korruptive qeveri-oligarki ndërsa sot do të prezantojë platformën për një proces zgjedhor të lirë. Sipas zyrtarit të lartë të PD-së të gjitha këto lëvizje politike, synojnë rikthimin e vendit në normalitet nëpërmjet rrugëve institucionale.



Edi Paloka, nënkryetari i PD-së

**Z.Paloka, opozita prej disa kohësh ka ndërmarrë një fushatë denoncimesh që u rralle kanë "shkundur" qeverinë, por nisura e fundit e kryeministrit Rama 'antishpifje' e frenon apo është një shtysë për një betejë me të ashpër kundër mazhorancës?**

"Antishpifja" e Ramës nuk është gjë tjetër veçse ashtu si "kallëzimet" në grup të zëvendësimit të tij, një tentativë për të mbuluar sa të mundet e për të tërhequr vëmendjen nga skandalet që nuk ndalen për këtë mazhorancë. PD dhe opozita kanë pesë vjet që denoncojnë me fakte të pakundërshtueshme çdo akt antikushtetues, antiligjor dhe korruptiv të Ramës dhe qeverisë së tij, kjo është detyra e parë e një opozite. Së fundmi, opozita ka qenë më e përqëndruar në situatën e rëndë që po kalon vendi lidhur me rendin dhe sigurinë publike si pasojë e lidhjeve direkte të qeverisë dhe vetë Ramës me krimin e organizuar.

Në këtë aspekt opozita i ka dhënë zë dhe mbështetje qytetarëve që ndihen të pafuqishëm përballë koalicionit qeveri-krim-oligarki.

Ngjarja e fundit në Bllok, në zonën më të populluar dhe që presupozohet dhe më të sigurtë të kryeqytetit, tregon jo vetëm pasigurinë e jetës në Shqipëri e Ramës por dhe fuqinë që ka marrë krimi me "rilindjen". Zhvillohet një betejë e vërtetë nga individë që janë në kërkim nga policia, që në vend të fshiheshin, bledhin të armatosur në zemër të kryeqytetit, vrasin dhe plagosin e pastaj largohen me qetësi. Autori kryesor

i krimit është dhe anëtarë i Forcave të Armatosura. Policia "kap" të vrasit. Kjo në zonën "me të sigurtë" të kryeqytetit, pak metra larg nga vendi ku të nesërmen Xhafaj ju fliste ministrave të Brendshëm të rajonit për sigurinë.

**Atëherë pse krimi ndihet kaq i fuqishëm?**

Për një arsye të thjeshtë, sepse ajo që duhet ta luftojë krimin, qeveria, është vetë pjesë e krimit. Djali i deputetit të "rilindjes" mund të të përdhunohet dhe gjithë shteti duhet filluar nga kryeministri, ngrihen në mbrojtje të përdhunuesit dhe sulmojnë denoncojnë e krimin. E ky nuk është rasti i parë dhe as i vetëm. Për Ramën janë "horrat" ata që guxojnë të denoncojnë. Atyre Rama ju qepet këmba-këmbës për t'ju mbyllur gojën. Kështu bëri me Zaganin, kështu po bën dhe me Nuhun. Ndërkohë kriminelët, vrasësit, përdhunuesit dhe trafikantët janë "heronjtë" e Ramës. Siç mburon sot Rrajën e Taulant Ballën, ka mbrojtur djë dhe Roshin, Habilajt, Tahirin e me radhë gjithë krimin që ai ka mbledhur rreth vetes. Rama është i lidhur fort me krimin, por në mënyrën më simbolike e shprehur së fundmi dhe përdhunuesi më i vogël i "rilindjes", i cili të vetmen fjalë që tha publikisht e kishte kërcënimin për kryetarin e opozitës; "do ta shohë në zgjedhje Luzlim Basha". Ky është thelbi i kësaj situatë sot në Shqipëri, e denoncuar prej kohësh nga opozita. Rama ka bërë pakt me krimin; ata i japin pushtetin duke marrë votat për të dhe ky i jep pushtetin të bëjnë ç'të duan pa i

prekur kush. Për këtë arsye ata përdhunohen, dhunohen, iu vënë gjoba e vrasin kë të duan se në fund e dinë që Rama nuk do t'i prekë. Se vetë zëvendësi i Ramës do shkojë t'i nxjerrë nga policia kur ndonjë "horr" të guxojë të merret me ta.

**Si mund t'i kundërvihet opozita...?**

E vetmja mënyrë për të shpëtuar vendin nga koalicioni i së keqes që Rama ka bërë me krimin, është t'i vëmë përballë koalicionin opozitë-qytetarë. Çdo qytetarë, intele-

ktual, i angazhuar ose jo, çdokush që kërkon të rrisë fëmijët në këtë vend pa patur frikë se ia dhunojnë apo përdhunojnë, kushdo që kërkon të ndërtojë jetën në këtë vend e nuk e sheh zgjidhjen tek ikja, duhet të bashkohet me opozitën për të larguar shkakuin e gjithë të këqijave që kanë pushtuar vendin që ka vetëm një emër; Edvin Rama.

**Ju kenë deklaruar se opozita do të ezaurojë të gjitha mënyra institucionale, e nëse Rama do të vijë të jetë në pushtet, atëherë opozita do të bëjë thirrje qytetarëve për revoltë. A besoni se shqiptarët do të ngrihen dhe do të rrëzojnë**

### REFORMA

"Ne kemi paraqitur propozimet tona për rikthimin në rrugën e kushtetutshmërisë të reformës në drejtësi, ndryshimet kushtetuese për vetingun në politikë, platformën kundër korrupsionit dhe lidhjeve korruptive qeveri-oligarki dhe të hënën paraqesim dhe platformën për një proces zgjedhor të lirë", -tha z.Paloka.

**Ramën për të cilin jeni shprehur se do ta tërheqin zvarrë...?**

Unë e kam thënë, siç më keni cituar: që opozita në rastin, kur rrugët institucionale të mos pranohen nga Rama, do t'i bëjë thirrje qytetarëve, të bashkohen me Frontin e Opozitës, për të rrëzuar Ramën e për ta çuar vendin drejt zgjedhjeve të lira.

**Mirëpo a keni besim se populli do t'i përgjigjet kësaj thirrjeje?**

Unë di të them që sot sipas gjithë sondazheve, janë mbi

sot është që çdo shqiptar që e sheh se asnjë të ardhme nuk ka me këtë qeveri, duhet të bashkohet me opozitën dhe t'i japim fund këtij tmerrri pafund.

**Megjithatë PD ka paraqitur disa platforma, të cilat do t'i konkretizojë sapo të vijë në pushtet, siç janë vetingu në politikë, ndryshimet në ligjin anti-mafia ndërkohë që sot prezantoni platformën për zgjedhje të lira...**

Opozita ka përgatitur dhe ka paraqitur në vazhdimësi disa platforma përmes të cilave mund të dilet nga kjo gjendje tejet e rëndë ku është futur vendi si rezultat i sundimit të së keqes nëpërmjet koalicionit qeveri-krim-oligarki. Ne kemi paraqitur propozimet tona për rikthimin në rrugën e kushtetutshmërisë të reformës në drejtësi, ndryshimet kushtetuese për vetingun në politikë, platformën kundër korrupsionit dhe lidhjeve korruptive qeveri-oligarki dhe të hënën paraqesim dhe platformën për një proces zgjedhor të lirë. Të gjitha këto lëvizje politike, synojnë rikthimin e vendit në normalitet



Një nga protestat e opozitës

të kryhet dhe për politikanët, SPAK apo Byroja e Hetimit, do të vendosin përpara përgjegjësisë penale politikanët që rezultojnë të korruptuar dhe në këtë rast vetingu në politikë vetëm ndihmon.

Është pikë për pikë procesi që zhvillohet sot në drejtësi dhe polici. Por sot, ndërsa një gjykatë përjashtohet nga drejtësia kur nuk vërtetohet që burimi i pasurisë së tij është i ligjshëm, Rama kryeministër mund të qëndrojë i qetë e të mos përgjigjet për vilat dhe luksin ku jeton megjithëse burimi i vetëm zyrtar i tij ka qenë rroga ne shtet. Një prokuror apo policë i thjeshtë, largohet po u vërtetua që ka lidhje qoftë dhe të largët me një person që mund të ketë patur qoftë dhe një dënim sado të lehtë penal. Ministri i Brendshëm mund të ketë vëlaim kapobandë e të dënuar për trafik droge po nuk e gjen gjë. Deputeti mund të ketë mik familjeje e t'i japë dhe tender trafikantëve të dënuar si Balla, madje ka deputetë që rezultojnë dhe bashkëpunorë direkt me bandat si Çurbja, po këta nuk i gjen gjë...Këta mund jo vetëm të qëndrojnë në politikë po dhe ta qeverisin këtë vend.

Ndërkaj platforma që po e quaj antioligarki, synon jo vetëm të shpëtojë lidhjet korruptive të qeverisë me disa biznesmenë pranë saj, por dhe të paralajmërojë biznesin e ndershëm që mos t'ndodhet nga ofertat korruptive në kurriz të interesave të qytetarëve. E çfarë është më e rëndësishmja, zbatimi i kësaj platforme do t'riktuheje qytetarëve paratë e grabitura nga kjo marrëdhënie korruptive qeveri-oligarki. Të gjitha këto iniciativa, sigurisht që të kthehen në ligje dhe të zbatohen, duan miratimin dhe të mazhorancës.

Kjo, unë jam i bindur që nuk do të ndodhë, sepe i pari që do të

### PER TOPIN DHE OKETEN

Në Frontin Opozitar kundër të keqes, janë të ftuara jo vetëm të gjitha partitë, shoqatat dhe organizatat politike apo shoqërore, po dhe çdo qytetar që sot e ka kuptuar dhe e ndjen se Rama duhet të ikë një orë e më parë për t'i hapur rrugë të ardhmes së Shqipërisë. Në krahun e opozitës dhe qytetarëve të ndershëm është i mirëpritur kushdo që kërkon të luftojë të keqen e madhe", -u shpreh nënkryetari i PD-së.

PD e vetme e ca më shumë opozita e sotme kanë zhvilluar protestat më të mëdha që janë zhvilluar ndonjëherë në këtë vend, pra dilema nëse do të na ndjekin ose jo e ka marrë përgjigjen. Ajo që kërkohet

nëpërmjet rrugëve institucionale. Kështu vetingu i politikaneve synon pastrimin e Parlamentit po dhe të politikës në përgjithësi nga politikanët e lidhur me krimin apo të korruptuar. Është një proces i njëjtë me vetingun në institucionet e drejtësisë apo vetingun e shpallur për punonjësit e policisë. Me pak fjalë: politikanët që rezultojnë të lidhur me krimin apo nuk justifikojnë pasuritë e tyre, largohen nga politika.

Tentativat e Ramës për ta paraqitur këtë si një proces që pengon reformën në drejtësi apo veprimtarinë e SPAK-ut dhe Byrosë së Hetimit, janë thjeshtë mashtrime për të mos lejuar që vetingu





← përgjegjje do të ishte vetë Rama. Por kjo nuk i bën të pavlefshme këto platforma pasi ato do të jenë hapat e parë që ne do të ndërmarim sapo të vijmë në pushtet.

**Ish-kryeministri Sali Berisha është shprehur se do të jetë vetëvrasje hyrja në zgjedhje me Edi Ramën pasi PD nuk do t'i fitonte ato për shkak të blerjes së votave. A do të hyjë PD në zgjedhjet lokale apo do tentohet që bashkë me to të zhvillohet edhe zgjedhjet e parakohëshme?**

Me Ramën nuk ka zgjedhje dhe ky është një fakt tashmë jo vetëm i deklaruar nga Berisha, jo vetëm i denoncuar nga PD-ja, por i pranuar dhe nga një pjesë e mirë e opinionistëve që nuk njihin si mbështetës të PD-së. Më e rëndësishmja, është një fakt me të cilin tanimë janë njohur dhe ndërkombëtarët. Është studimi i BE-së ai i cili evidentoi se 20% e shqiptarëve deklarojnë se e kanë shitur votën. Pra, 20 përqind janë vetëm ata që e deklarojnë. Atëherë për çfarë zgjedhesh mund të flasin në Shqipëri? Në një vend ku kriminelët i kërcënohen opozitës "do na shohësh në zgjedhje", sepse janë në rolin që ju ka caktuar kryeministri i vendit, për çfarë zgjedhesh mund të flitet?

**Pavarësisht situatës që ju përmbendi, a do të marrë pjesë opozita në zgjedhjet lokale?**

Sigurisht, në demokraci zgjedhjet janë ato që përcaktojnë se kush qeveris vendin. Ne po bëjmë të gjitha përgatitjet dhe shpejtë do të jemi gati bashkë me kandidatët tanë. Shqipëria nuk do të mbetet pa zhvilluar zgjedhje, sepse Rama nuk lejon zgjedhje të lira e të ndershme. Ne e kemi bërë ndërkohë zgjedhjen tonë midis dy alternativave; vendi pa zgjedhje, pa demokraci apo pa Ramën? Ne kemi

zgjedhur demokracinë.

**A ka çarje brenda koalicionit pas ardhjes së Shpëtim Idrizit në koalicionin opozitar, nisur nga ndasitë që PDIU ka me PBDNJ-në e Dules?**

Nuk ka asnjë përcarje në Frontin Opozitar, ka vetëm zgjerim të këtij fronti. Sot jemi të gjithë kundër së keqes. Rama është ai që ka mbetur vetëm dhe po vazhdon të braktiset përditë edhe nga vetë socialistet. Sot jo vetëm partitë në Frontin Opozitar, por dhe shumë intelektualë me bindje të majta apo siç përmenda më lart dhe socialistë të ndershëm, anëtarë të PS-së, janë bindur se Rama është një e keqe që duhet larguar një orë e më parë.

**Me kë parti tjetër synon PD aleancë kundër Ramës? A do ketë një ftesë edhe për FRD-në e Bamir Topit? Gazmend Oketa është tërhequr nga politika, pasi sipas tij nuk mund të qëndrojë në një sallë me kriminelët, por a do të ketë**

Nënkrjetari i PD thirrje shqiptarëve: Bashkohuni me opozitën që të përmbysim oligarkët

# Zgjedhjet, Paloka: Nuk bojkotojmë, po zgjedhim kandidatët tanë

"Çfarë ndodh nëse rrëzohet vetingu dhe antimafia"

këmbë vetëm prej numrit artificial të deputetëve në parlament. E vetmja shpresë e tij është se koalicioni që ka bërë me krimin dhe oligarkinë do të vazhdojë ta mbajë në pushtet. Në krahun tjetër, në krahun e opozitës dhe qytetarëve të ndershëm është i mirëpritur kushdo që kërkon të luftojë këtë të keqe të madhe që ka pushtuar sot vendin.

**Cilat do të jenë raportet e opozitës me Kuvendin, deri kur do të vazhdojë bojkoti?**

Raportet e opozitës me Kuvendin tanimë janë të qarta. Një parlament që nuk ka përfaqësuar që ditën e parë vullnetin e shqiptarëve, një parlament që është kthyer në strehë dhe mburojë e kriminit, një parlament që nuk pyet për Kushtetutën, një parlament që përdoret nga Rama për të grabitur me ligje speciale korruptive, pronat publike dhe private, tani ka mundësinë të kryejë vetëm një funksion dhe t'i bëjë një nder të fundit vetes, por sidomos shqiptarëve; të miratojë propozimet e opozitës për shkëputjen e politikës nga lidhjet me krimin e organizuar, prishjen e marrëdhënieve korruptive qeveri-oligarki, kthimin në kushtetutshmëri të reformës në drejtësi dhe krijimin e kushteve për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Në rrethana të tilla sigurisht që ne do të jemi të pranishëm në parlament. Duhet t'u kujtojmë që përveç këtyre iniciativave, ne kemi kërkuar dhe shtyrjen e



Ramës.

Kreu i PD-së ka vënë kushte se pa bërë vetingun e politikës nuk do të ketë asnjë pakt me Edi Ramën. Përdërisa opozita nuk i ka votat në Kuvend pse refuzon dialogun me mazhorancën?

Nuk ka asnjë pakt me Ramën dhe nuk mund të ketë. Vetingu në politikë ose pranohet ose nuk pranohet, çfarë ka këtu për t'u ulur e dialoguar. Procesi i vetingut në politikë është i njëjti me atë të institucioneve në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese janë të njëjtat që janë diskutuar dhe janë miratuar dhe nga Komisioni i Venecias, atëherë për çfarë duhet të uleri me Ramën apo për pazare?

**Çfarë do të ndodhë nëse mazhoranca nuk do të pranojë vetingun në politikë?**

Unë jam i bindur që Rama nuk do e pranojë vetingun për politikanët, sepse e di mirë që i pari që do të largohet nga politika do të ishte ai si për lidhjet e tij direkte me krimin, ashtu dhe për pasurimin nëpërmjet korupsionit. Në këto kushte opozitës nuk i mbetet gjë tjetër përveçse t'ju bëjë thirrje shqiptarëve që të bashkohen për ta shpëtuar vendin nga kjo e keqe. E keqja nuk ikën vetë. Atëherë duhet larguar me dhunë. E përsëris, qytetarët e ndershëm duhet të bashkohen në një koalicion me opozitën për të qeruar një orë e më parë koalicionin e qelbësirave që sollli dhe mban në pushtet Edvin Ramën.

**Ju thonë që z. Rama duhet larguar me dhunë, por kreu i PD-së ka deklaruar se kryeministrin nuk mund ta rrëzojë me dhunë, por popullin këtë e bën për një javë...?**

Sigurisht edhe unë për popullin po flas. Nuk e rrëzoj as Basha, as unë, popullin e rrëzon. Kur flas për "dhunë" kam parasysh largimin e tij nga njerëzit me protesta dhe reagim të fortë.

Ne kemi denoncuar shkeljet kushtetuese dhe grabitjen me ligj të pronës publike dhe private. Kemi paralajmëruar me platformën antioligarki se të gjitha ato biznese që do të hyjnë në marrëdhënie korruptive me qeverinë, siç është dhe rasti i Teatrit, nesër do të mbajnë jo vetëm përgjegjësi penale por dhe do t'ju konfiskohen të gjitha pasuritë.

Ndërkohë ne kemi qenë gjithë kohën në mbështetje të atyre që protestojnë prej një kohe të gjatë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar. Duhet të thjeshtoj se kjo është e njëjtë me të madhe se sa thjeshtë mbrojtja e godinës së Teatrit dhe nuk zgjidhet thjeshtë duke mos lejuar

Asnjë diktator nuk ikën më dëshirë.

**Do t'i puni njerëzit "mish për top" ...?**

Jo kjo nuk do të thotë që ne do t'i çojmë njerëzit "mish për top" siç bëri Rama me 21 janar. Rama bën të fortin se

## RREZIMI

"Ramën nuk e rrëzoj as Basha, as unë, populli e rrëzon. Kur flas për "dhunë" kam parasysh largimin e tij nga njerëzit me protesta dhe reagim të fortë. Asnjë diktator nuk ikën më dëshirë. Kjo nuk do të thotë që ne do t'i çojmë njerëzit "mish për top" siç bëri Rama me 21 janar. Rama bën të fortin se është i bindur që këtëj populli "nuk i çohet", -tha z.Paloka.

është i bindur që këtëj populli "nuk i çohet". E mban mend shprehjen e tij me arrogancë përpara protestës së kuksiarëve në Rrugën e Kombit. E mban mend dhe si i dridhje zëri pa proteste. Më pas filloi dhe e trashi zërin prapë. E pra, qytetarët e kanë në dorë të mos e lejojnë ta trashë zërin prapë. Ne do jemi me ta, jo të fshehur pas tyre si Rama, por në krah dhe në krye të tyre kur të jetë nevoja.

**Lidhur me ligjin e ri për Teatrin Kombëtar, si do ta parandalojë PD shembjen e godinës duke marrë parasysh se edhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese është në pikëpyetje për shkak se kjo gjykatë nuk funksionon prej muajit mars...?**

Ligji i ashtuquajtur "Për Teatrin Kombëtar" është një nga aktet më domethënëse që vërtetëojnë se Rama në funksion të vjedhjes dhe grabitjes së qytetarëve të këtij vendi, nuk ndalet përpara asgjëje. Nuk ndalet as përpara shkeljes së Kushtetutës e as përballë kundërshtive të qytetarëve dhe intelektualëve. Në këto kushte opozita do të bëjë gjithçka që ka në dorë.

**Çfarë konkretisht...?**

shembjen e kësaj godine. Kjo është dhe shumë çështje të tjera që i kanë ngritur shqiptarët në protesta, sipas grupeve të ndryshme dhe interesave të ndryshme, në fakt kanë një zgjidhje të përbashkët dhe është largimi i Ramës nga pushteti.

Asnjë problem, asnjë çështje nuk do të gjejë zgjidhje në këtë vend deri sa shkaktari dhe krijuesi i këtyre problemeve të vazhdojë të pushtetërojë, përkundrazi problemet që ai gjenoren vetëm do të shtohen. Prandaj të gjitha këto grupe; mbrojtësit e teatrit, bizneset që po falimentojnë përditë, minatorët e naftëtarët, studentët e pensionistët, nxënësit e shkollave të mbyllura dhe prindërit e tyre, ata që ju është hequr ndihma sociale dhe të papunët, fermerët që po ju kalben prodhimet, viktimat e kriminit ordiner dhe atij qeveritar...të gjithë duhet të bashkohen në një protestë të vetme me një qëllim të vetëm; të largojnë shkaktarin e vetëm të fatkeqësive të tyre dhe fatkeqësive të gjithë shqiptarëve, të largojnë të keqen që ka vetëm një emër, Edvin Rama.

## VRASJA NE BLOK VENDIMI I GJYKATES

Qinami: S'ka gjurmë gishtash të Eljon Hates në vendngjarje

# Avokatët e dy të plagosurve: S'ka prova për t'i përfshirë

"Martinaj ka pasur marrëdhënie korrekte me Matën"

Avokatët e dy shokëve që mbetën të plagosur gjatë konfliktit në bllok të enjten mbrëma, Eljon Hato dhe Ervis Martinaj, kanë kërkuar pafajësi për klientët e tyre duke u shprehur se nuk ka asnjë provë për përfshirje në konfliktin me armë. Avokati Mirash Martini tha se biznesmeni i plagosur si pasojë e përplasjes me armë në zonën e ish-Blokut, Ervis Martinaj nuk është përfshirë në konflikt dhe kërkesa e prokurorisë për 'arrest me burg' është e papërshtatshme. "Nuk ka të dhëna se Martinaj ishte i përfshirë në konflikte. Sherri ka qenë mes dy personave, Fabjan Gaxhës, i cili është konfliktuar në mënyrë verbale me komandon që nuk njihje nga Ervin Matën. Martinaj nuk ka pasur lidhje me këtë ngjarje. Ervis Martinaj ka pasur marrëdhënie korrekte me Ervin Matën, janë takuar në lokal. Ai të vijë dhe të japë sqarime, sepse nuk rezultoi që të ketë pasur konflikt mes Ervin Matës dhe Vis Martinajt. Në sherr nuk ishte i përfshirë klienti im. Ka qenë i pranishëm, por s'ka qenë pjesë e sherrit. Në sherr janë përfshirë Gaxhaj dhe ai që është identifikuar si komando", ka thënë avokati i Ervis Martinajt, Mirash Martini. Gjatë ditës së djeshme prokuroria mori në pyetje në spital biznesmenin e basteve Ervis Martinajn për të hedhur më shumë dritë mbi ngjarjen.

### AVOKATI I HATES

Zeni Qinami avokati i Eljon Hates, i cili ndodhet i plagosur në spital ka thënë se nuk ka prova për vendosjen e masës 'arrest me burg' ndaj klientit të tij. Në një prononcim për News24 dhe BalkanWeb, avokati i të plagosurit Eljon Hato ka thënë se nuk provohet akuzat e ngritura nga prokuroria për masën 'arrest me burg'. "Ishim në seancë gjyqësore te spitali ushtarak në Tiranë. Prokuroria ka kërkuar kaktimin e masës së sigurimit me burg për Haten. Unë kërkova në seancë që gjykatë të vlerësonte si të paligjshëm arrestimin në flagrancë, pasi

nuk janë kushtet dhe rrethanat për të caktuar këtë masë sigurimi. Nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm të mbështetur në prova. Ai akuzohet për një vepër penale të


rëndë. Asnjëra nga pretendimet e prokurorisë për ne si mbrojtje nuk janë të bazuara në ligj. Vendimi do të jepet më vonë. S'ka as shenjë gishtash, as gjurmë të qitjes. Pamje

filmike nuk ka pasur. S'më duket asnjë provë bindëse për të provuar akuzat e prokurorisë. Ai është i pafajshëm në këtë situatë", ka thënë Zeni Qinami avokati i Eljon Hates.



Ervis Martinaj

Eljon Hato



Vendi ku ndodhi ngjarja

## Sherri



### BIZNESMENI I PLAGOSUR

Avokati Mirash Martini tha se biznesmeni i plagosur si pasojë e përplasjes me armë në zonën e ish-Blokut, Ervis Martinaj nuk është përfshirë në konflikt dhe kërkesa e prokurorisë për 'arrest me burg' është e papërshtatshme. "Nuk ka të dhëna se Martinaj ishte i përfshirë në konflikte. Sherri ka qenë mes dy personave, Fabjan Gaxhës, i cili është konfliktuar në mënyrë verbale me komandon që nuk njihje nga Martinaj.

## Viktima Fabian Gaxha, pse ndodhi sherri

# Një i vrarë e dy të plagosur në ish-Blok, dinamika e ngjarjes

Një person vdiq dhe 2 të tjerë u plagosën me 4 tetor në një lokal në ish-Blok. Viktimë e ngjarjes të së enjtes mbrëma është Fabian Gaxha ndërsa i plagosur ka mbetur Ervis Martinaj, biznesmeni i njohur i pikave të basteve si edhe Eljon Hato, të cilët kanë qenë së bashku në lokal. Sipas dëshmitave që ka marrë policia në vendngjarje, konflikti ndodhi në kushtet kur në lokal ndodheshin Ervis Martinaj dhe Eljon Hato ky i fundit i njohur edhe me emrin Esmeraldo, dhe 2 persona të tjerë të pidentifikuar, ndërsa diku më larg Ervin Mata, e dashura e tij Elvana Gjata, Fabio Alushi, Meviol Bilo si dhe 2 të tjerë ende të pidentifikuar. Situata në lokal mes palëve ka qenë e qetë për disa minuta dhe nuk ka pasur komunikim mes tyre. Rreth orës 21.30 në lokal shkoi Fabian Gaxha, truproja i Ervis Martinajt. Sapo e ka parë Mata i ka kërkuar të



Viktima Fabian Gaxha

sqarohen për një ngacim që i kishte bërë të dashurës së tij, këngëtares Elvana Gjata dhe një vajze tjetër të showbizit. Burimet nga hetimet thonë se mes palëve ka patur konflikte edhe më herët dhe ngacimi i këngëtares mund të jetë përdorur si pretext. Duke

parandierë se gjakrat do të nxeheshin pronari i lokalit Redi Popesku i kërkoi Elvanës të largohet. Disa minuta pasi u largua, këngëtarja u rikthye për t'i kërkuar të dashurit të largohet. Burimet thonë se ajo nuk hyri më në ambientet e brendshme të lokalit dhe

### DESHMITARET

Konflikti ndodhi në kushtet kur në lokal ndodheshin Ervis Martinaj dhe Eljon Hato ky i fundit i njohur edhe me emrin Esmeraldo, dhe 2 persona të tjerë të pidentifikuar, ndërsa diku më larg Ervin Mata, e dashura e tij Elvana Gjata, Fabio Alushi, Meviol Bilo si dhe 2 të tjerë ende të pidentifikuar.

pas largimit për herë të dytë, konflikti u ashpërsua. Kur Fabiani u afrua nisi konfrontimi fizik. Mata e ka goditur disa herë me grusht duke e ulur në tokë. Më pas në ndihmë të Fabianit erdhën Ervis Martinaj dhe Eljon Hato, menjëherë ka nisur shkëmbimi i zjarrit mes

palëve dhe në këto çaste Meviol Bilo, pjesë e forcave ushtarake, qëlloi mbi grupin rival duke vrarë Fabian Gaxhën dhe duke plagosur Ervis Martinajn dhe Eljon Haten. Burime për "BalkanWeb" saktësisht an se Meviol Bilo, me gradë rreshter, me detyrë specialist xhenio i Batalionit të Forcave Speciale, ishte i punësuar nga këngëtarja Elvana Gjata si truproja e saj. Mësohet se Bilo nuk ka qenë me armën e shërbimit në momentin e krimit, ndërsa hetimet do të përcaktojnë se kujt i përkiste ajo. Në vendngjarje policia gjeti 11 gëzhoja, arme zjarri tip 'Glock', 10 000 euro, aparate celularë dhe 3 automjete. Pak pas krimit policia gjeti edhe një motor në zonën e Kopshtit Botanik që dyshohet se ka lidhje me ngjarjen. Ekspertët të kriminalistikës shkuan në vendngjarje dhe vijojnë hetimet me sekuestrimin e kamerave.





Avokati: Gjendja shëndetësore e Hates shumë e rëndë

# Lihen në burg Ervis Martinaj dhe shoku i tij Eljon Hate

*Seancat gjyqësore u zhvilluan nëpër spitale*

TIRANE

Pavarësisht pretendi meve të avokatëve për pafajësi, Gjykata Penale e Tiranës ka vendosur masën 'arrest me burg për 30 ditë' për dy të plagosurit Ervis Martinaj dhe shokun e tij Eljon Hate, pas përplasjes me armë në një lokal në ish-Bllok mbrëmjen e së enjtes. Në konfliktin e ndodhur mbrëmjen e së enjtes në një lokal në këtë zonë mbeti i vrarë Fabian Gaxha. Prokurorët e Krimeve të Rënda Kreshnik Ajazi dhe Artan Lulo kërkuan dhënien e masës 'arrest me burg' për të dy të arrestuarit, Ervis Martinaj dhe Eljon Hate. Seanca u zhvillua këtë të diel në një spital privat dhe te Trauma në kryeqytet, aty ku ndodhet të shtruar dy të plagosurit. Gjatë ditës së djeshme prokuroria mori në pyetje në spital biznesmenin e basteve Ervis Martinajn për të hedhur më shumë dritë mbi ngjarjen. Në lidhje me ngjarjen dy ditë më parë u arrestua në Kakavijë edhe Galdo Hoti, pasi dyshohet se është njëri nga personat që ka qëlluar me armë zjarri në lokal. Ai ishte pjesë e tavolinës së tre personave që ndodhen në kërkim. Dyshohet se 'mollë shërr' për konfliktin mes 7 personave ka qenë ngacimi i këngëtares Elvana Gjata, e cila ndodhej në lokal bashkë me të dashurin e saj,



i cili është në kërkim. Megjithatë policia dhe prokuroria janë duke hetuar edhe për një konflikt të mëparshëm mes palëve. El-

jon Hate sipas avokatit të tij ndodhet në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. Ai ndodhet në reanimacion në luftë me jetën, ndërsa nuk arrin

të komunikojë dot me asnjë. Zeni Qinami avokati i Eljon Hates këtë deklaratë e bëri menjëherë pasi doli nga spitali.

MASA

Në konfliktin e ndodhur mbrëmjen e së enjtes në një lokal mbeti i vrarë Fabian Gaxha. Prokurorët e Krimeve të Rënda Kreshnik Ajazi dhe Artan Lulo kërkuan dhënien e masës 'arrest me burg' për të dy të arrestuarit, Ervis Martinaj dhe Eljon Hate. Seanca u zhvillua këtë të diel në një spital privat dhe te Trauma në kryeqytet, aty ku ndodhen të shtruar dy të plagosurit.

## I ARRESTUAR

I arrestuar në Kakavijë në tentativë për t'u larguar:  
**Galdo Hoti**

## TË PLAGOSUR

Të plagosur dhe në masë arresti:  
**Ervis Martinaj**, 36 vjeç, banues në Tiranë  
**Eljon Hate**, 28 vjeç, banues në Shkodër

## NË KËRKIM:

**Ervin Mata**, 31 vjeç, banues në Tiranë ( I dashuri i Elvana Gjatës)  
**Fabio Allushi**, 42 vjeç, banues në Tiranë;  
**Mevjoli Bilo**, 41 vjeç, banues në Tiranë; (Komando dhe truporë i Elvana Gjatës, autor i dyshuar i vrasjes së Fabian Gaxhës)

## Arrestohen dy elbasanllinj me kokainë dhe kanabis

**ELBASAN.** Policia e Elbasanit ka arrestuar dy persona, pasi gjatë kontrollit në banesë u janë gjetur kokainë dhe kanabis. Në pranga kanë përfunduar Arben Farka, 35 vjeç, banues në lagjen 11 Nëntori, Elbasan dhe Gramos Nasto, 41 vjeç, banues në lagjen "Dyli Haxhire" Elbasan. Sipas policisë, dy të arrestuarit në lagjen "11 Nëntori", për motive të dobëta janë konfliktuar me njëri-tjetrin dhe më pas janë larguar nga vendi i ngjarjes. Efektivat e Komisarariatit të Policisë Elbasan, kanë ushtruar kontrollin në banesat e shtetasve, ku Farka ka kundërshtuar punonjësit e policisë për kontrollin e banesës së tij. Policia gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi gjeti dhe sekuestroi një dozë me lëndë narkotike të dyshuar si kokainë, ndërsa në banesën e shtetasit G. Nasto, gjeti dhe sekuestroi 2.4 gramë lëndë narkotike të dyshuar si Cannabis Sativa. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale, "Kundërshtimi i



## Ngjarja

Dy të arrestuarit në lagjen "11 Nëntori", për motive të dobëta janë konfliktuar me njëri-tjetrin dhe më pas janë larguar nga vendi i ngjarjes. Efektivat e Komisarariatit të Policisë Elbasan, kanë ushtruar kontrollin në banesat e shtetasve, ku Farka ka kundërshtuar punonjësit e policisë për kontrollin e banesës së tij.

punonjësit të policisë së rendit publik", "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga nenet 236/2 dhe 283 të Kodit Penal për shtetasin A.Farka ndërsa shtetasi G.Naso për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,388,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

Oferita duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 30 Tetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Zyra përbarimtare "Best 2010"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 19 nëntor 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyra përbarimtare do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e pasurisë "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës.

Prona përbëhet nga dy dyqane (gjithësej rreth 245 m2) dhe tre apartamente (gjithësej rreth 245 m2) dhe mbi këto pronë nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kufizuara nga detyrime të tjera.

Gjithësej rreth 245 m2, ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë 56700 lek/m2.

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644



Ndërhyrja e zjarrfikëve për të nxjerrë nga makina të aksidentuarit, dje në Surrel



Shkaku ende i paqartë. Në Lushnjë vdes një 35-vjeçare

# Aksident i rëndë në Surrel, vdes 38-vjeçari

## Humb jetën 38-vjeçari Florenc Vishkurti

Një aksident i rëndë ka ndodhur rreth orës 18,30 në fshatin Surrel të Tiranës, ku një makinë fuoristradë ka dalë nga rruga dhe ka përfunduar në greminë. Viktimë në këtë aksident ende të paqartë për shkaqet është 38-vjeçari Florenc Vishkurti, që për fat të keq nuk mundi t'i rezistojë plagëve të marra, duke ndërruar jetë rrugë për në spital. Ndërkohë të plagosur rëndë janë edhe Lulzim Balla dhe Zyhdil Alcani që u dërguan në spital për trajtim mjekësor. U desh ndihma e zjarrfikësve për të nxjerrë të aksidentuarit nga automjeti që ishte shtypur thuajse tërësisht. Ambulanca e parë u largua nga vendi i ngjarjes me njërin prej të aksidentuarve në ora 19:30 e dyta rreth 5 minuta më vonë ndërsa në orën 20:30 ambulanca me të aksidentuarin e fundit.

### AKSIDENTI TJETËR

Një aksident i ndodhur të dielën në Lushnjë i ka marrë jetën një vajze, ndërsa ka përfunduar në burg familjari i saj 21-vjeçar. Altin Durra u arrestua pasi sot rreth orës 07:20, në autostradën Lushnjë-Rrogoshinë, në fshatin Konjat, Lushnjë, duke drejtuar mjetin tip "Volkswagen", ka humbur kontrollin dhe ka dalë nga rruga. Si pasojë e daljes nga rruga humbi jetën 35 -vjeçarja Marsla Durra që ishte nusja e xhaxhait të Altinit. Materialet do i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë për veprën penale "Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga Neni 290 i Kodit Penal.



U desh ndihma e zjarrfikësve për të nxjerrë të aksidentuarit nga automjeti që ishte shtypur thuajse tërësisht.

### ERSEKE

#### Sherr me thika në Ersekë, plagoset shoferi i urbanit

Një sherr me thika në qytetin e Ersekës ka përfunduar me plagosjen e një personi. Ngjarja ka ndodhur te stacioni i Ersekës, ku në grindje janë përfshirë shoferi i një autobusi dhe i një furgoni. Nga raportimet e para thuhet se grindja ka qenë për motive banale. Si pasojë e sherrit ka përfunduar i plagosur shoferi i autobusit Mari-glen Sardi. Ndërsa shoferi i furgonit që punon taksi pa licencë, Rei Elmasllari, ka qëlluar tre herë me thikë shoferin e autobusit, i cili përfundoi në spital. Mësohet se edhe ditë më parë, Elmasllari ka kërcënuar me dru shoferin e autobusit.

### Tjetër aksident në Pishkash, dëmet e rënda, por pa viktime

## Përplasen me makinë katër gjyqtarë futbollit


### AKSIDENTI



Katër gjyqtarët janë Amarildo Gjeci, Ergin Morina, Xhuljan Rroshi dhe Daniel Vrapit. Katërshja e gjyqtarëve konfirmohet se po udhëtonin drejt qytetit të Maliqit ku këtë të diel do gjykonin një ndeshje të Kategorisë së Dytë.

iqtin ku këtë të diel do gjykonin një ndeshje të Kategorisë së Dytë. Sipas burimeve zyrtare ata ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Ndërko-

hë, takimi i parashikuar për të filluar në orën 14:00, do të shtyhej me 30 minuta për shkak të kësaj ngjarjeje, raportuan burime nga



FSHF. Ndërkaq një tjetër aksident ka ndodhur në vendin e quajtur Kthesa e Pishkashit, ku janë përfshirë një furgon dhe një autoveturë, të cilat kanë pësuar dëme të konsiderueshme materiale. Nga përplasja mjetit tip "Ford" me targa AA108MT me mjetin tip "Benz", me targa AA269AE janë plagosur tre persona, të cilët janë transportuar në spitalin e Përrenjasit dhe ndodhet jashtë rrezikut. Në këtë ngjarje policia njoftoi se mjeti tip

"Ford" me targa AA 108 MT me drejtues shtetasin I.I. 22 vjeç, banues në Shkodër, është përplasur me mjetin tip "Benz", me targa AA 269 AE, me drejtues shtetasin B.C., 59 vjeç banues në Librazhd. Si pasojë e aksidentit janë aksidentuar drejtuesi i mjetit dhe 2 pasagjerë, të cilët ndodheshin në mjetin tip "Benz", të cilët janë transportuar në spitalin e Përrenjasit dhe janë jashtë rrezikut për jetën.

Fatmir Popja

**Shitje me Ankand të dyle nga Studio Permbarimore L.D.C**  
 Shitje me Ankand të dyle nga Studio Permbarimore L.D.C  
 -Apartamentin me nr. 2/260+2-6, vol.30, faqe 140, sip. 104.12 m<sup>2</sup>, ZK 8330, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 4.700.000 Leka.  
 Data e shpalljes 11.09.2018  
 Data e zhvillimit 11.10.2018 deri ne oren 16.00  
 Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adrese Rruga "Myslim Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



Kreu i këshilltarëve të LSI: Qëndrimi i kushtëzuar, pasojë e shkeljes së ligjit

# Opozita braktis mbledhjet e Këshillit Bashkiak, zbardhen shkaqet kryesore

Eltjon Halimi: Po diskutojmë vendimin për djegien e mandateve

Voltiza Duro

P prej disa muajsh, anëtarët e opozitës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, pas dhënies së votës pro për vendimet me karakter social, largohen nga mbledhja e Këshillit Bashkiak. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', kryetari i grupit të këshilltarëve të LSI në Bashkinë Tiranë, prof. Eltjon Halimi tregon arsyet që i kanë detyruar anëtarët e opozitës të braktisin mbledhjet. Sipas tij ky është një qëndrim i kushtëzuar nga ngjarjet e fundit që kanë ndodhur, në shkelje të ligjit dhe kushtetutës, që kanë detyruar këshilltarët e opozitës, të mbajnë një qëndrim të tillë. Halimi më tej thekson se zgjidhja më e mirë është zbatimi i ligjit, dhe rikthimi i kompetencave që kushtetuta u njeh autoriteteve kolegjiale të qeverisjes vendore. Opozita është në një marrëdhënie të drejtave të komunitetit, dhe kundër çdo vendimarrjeje në interes antiligjor të oligarkëve. Ndaj edhe këshilltarët e opozitës marrin pjesë aktive në komisionet ku diskutohen paraprakisht vendimet e Këshillit si dhe japin votën e tyre pro, për çdo vendim të ndihmës ekonomike dhe sociale. Por, unë mund t'ju them, se kjo situatë, e cila nuk po gjen zgjidhje dhe respektim ligjor, po agravoheft çdo ditë e më shumë, dhe në radhët e kampit opozitar në Tiranë, që tashmë, është zgjeruar përtej dy partive kryesore të opozitës, LSI dhe PD, edhe me parti apo faktorë të tjerë, është duke u diskutuar edhe vendimi i djegies së mandateve nga këshilltarët bashkiak të opozitës. Unë uroj që maxhoranca të reflektojë, dhe të mos detyrojë opozitën në Këshillin Bashkiak të ndërmarrë këtë akt fundor.

**Prej kohësh, anëtarët e opozitës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, braktisin mbledhjet? Pse ky reagim nga ana juaj?**

Po, është e vërtetë, që në mbledhjet e fundit, opozita e bashkuar në Këshillin Bashkiak ka mbajtur një qëndrim të kushtëzuar me këtë Këshill. Por kjo nuk ka qenë aspak një zgjedhje e jona, por një qëndrim i kushtëzuar nga ngjarjet e fundit që kanë ndodhur, në shkelje të ligjit dhe kushtetutës, të cilat kanë detyruar këshilltarët e opozitës, të marrin një qëndrim të tillë, për të mos marrë pjesë në mbledhjet e këshillit, por jo vetëm pasi ne japim votën tonë pro për të gjitha vendimet e ndihmës ekonomike dhe sociale.

**Ku janë konstatuar shkeljet e ligjit nga këshilltarët e opozitës?**

Për të sqaruar opinionin publik, ne si këshilltarët të opozitës, kërkuam që të zbatohet një detyrim moral i një vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila kishte konstatuar pavlefshmëri juridike, për 6 mandate këshilltarësh, të cilët



Eltjon Halimi, kryetari i grupit të këshilltarëve të LSI në Bashkinë Tiranë

## ELTJON HALIMI

Unë mendoj që zgjidhja më e mirë është zbatimi i ligjit, dhe rikthimi i kompetencave që Kushtetuta u njeh autoriteteve kolegjiale të qeverisjes vendore. Opozita është në një marrëdhënie të kushtëzuar, dhe nuk është në një braktisje. Ne nuk kemi braktisur interesat e qytetarëve, por përkundrazi, veprimet tona, janë në mbrojtje të të drejtave të komunitetit, dhe kundër çdo vendimarrjeje në interes antiligjor të oligarkëve.

nuk kishin kryer betimin në zbatim të ligjit dhe kushtetutës. Për këtë ne kemi kërkuar, që nuk mund të jemi pjesë e një organi me mandate të pavlefshme, pasi në këtë mënyrë, edhe vendimet tona do të konsideroheshin nul nga gjykatat. Dhe ky ka qenë thelbi i kërkesës sonë, mosvotimi i vendimeve nga këshilltarët pa mandate të vlefshme, në mënyrë që vendimet e këshillit të kishin vlefshmëri dhe duhur. Më pas, vendimi i Gjykatës së Apelit, vendosi në kundërshtim me vendime e parë, dhe në këto kushte ne duke njohur dhe respektuar çdo vendim të organeve të pavarura, pavarësisht gjykim-it tonë, u rikthyem në këshill. Por përsëri u gjetëm përballë uzurpimit të kompetencave tona, që na njeh ligji.

**Mbledhjet e fundit të Këshillit Bashkiak të Tiranës, janë shoqëruar edhe me debate të forta mbi Teatrin Kombëtar. Mund të analizoni disa prej arsyeve kryesore?**

Në ligjin për pushtetin vendor, në nenet e tij 54 dhe 55, si dhe Kushtetuta e vendit në nenin e saj 113, fryma e Konventës së Autonomisë Vendore për decentralizim dhe balancim të pushteteve vendore dhe qendrore, në të cilat theksohet qartë që "tjetërsimi i hapësirave publike, kërkon 3/5 e votave të anëtarëve të Këshillave vendorë". Kjo kompetencë e jona, për hapësirën e Teatrit Kombëtar, prej 2100 metrash që është në pronësi të qytetit të Tiranës, nuk u zbatua dhe kaloi në këshill. Për ne si këshilltarë, si gardianë të interesit të qytetarit, është shumë e rëndësishme që këshilltarët të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore, në mirë qeverisje të qytetarëve që i kanë mandatuar. Në funksion të kësaj që shpjegova, dhe duke qenë të bindur, se vetëm zbatimi i ligjit, dhe jo shkelja e tij, është detyrim ligjor dhe moral i çdo të zgjedhuri, ne kemi qenë të detyruar për këtë zgjedhje nga ana e jonë, duke pritur një reagim nga

## OPOZITA

Është e vërtetë, që në mbledhjet e fundit, opozita e bashkuar në Këshillin Bashkiak ka mbajtur një qëndrim të kushtëzuar me këtë Këshill. Por kjo nuk ka qenë aspak një zgjedhje e jona, por një qëndrim i kushtëzuar nga ngjarjet e fundit që kanë ndodhur, në shkelje të ligjit dhe kushtetutës, të cilat kanë detyruar këshilltarët e opozitës, të marrin një qëndrim të tillë, për të mos marrë pjesë në mbledhjet e këshillit

## më e mirë?

Unë mendoj që zgjidhja më e mirë është zbatimi i ligjit, dhe rikthimi i kompetencave që Kushtetuta u njeh autoriteteve kolegjiale të qeverisjes vendore. Opozita është në një marrëdhënie të drejtave të komunitetit, dhe kundër çdo vendimarrjeje në interes antiligjor të oligarkëve. Ndaj edhe këshilltarët e opozitës marrin pjesë aktive në komisionet ku diskutohen paraprakisht vendimet e Këshillit si dhe japin votën e tyre pro, për çdo vendim të ndihmës ekonomike dhe sociale. Por, unë mund t'ju them, se kjo situatë, e cila nuk po gjen zgjidhje dhe respektim ligjor, po agravoheft çdo ditë e më shumë, dhe në radhët e kampit opozitar në Tiranë, që tashmë, është zgjeruar përtej dy partive kryesore të opozitës, LSI dhe PD, edhe me parti apo faktorë të tjerë, është duke u diskutuar edhe vendimi i djegies së mandateve nga këshilltarët bashkiak të opozitës. Unë uroj që maxhoranca të reflektojë, dhe të mos detyrojë opozitën në Këshillin Bashkiak, për të ndërmarrë këtë akt fundor të veprimtarisë politike të organeve kolegjiale të zgjedhura me votë të qytetarëve.

**Sipas jush si duhet negociuar për zgjidhjen e situatës?**

Siç e theksova dhe më sipër, negociatat duhet të bazohen vetëm në zbatimin e ligjit, kushtetutës, dhe frymës së decentralizimit sipas konventave dhe organizimeve ndërkombëtare dhe europiane të qeverisjes vendore. Negociatat duhet të kenë si qëllim vetëm kthimin e qeverisjes vendore të qytetarit, dhe përmirësimin i jetesës së komunitetit të Tiranës dhe zonave përreth. Unë vazhdoj të besoj, që maxhoranca në këshill, do t'i bashkohet kërkesave të opozitës, të cilat janë vetëm në zbatim të ligjit të frymës kushtetuese të decentralizimit vendor, në mënyrë që t'i shërbejnë qytetarëve që na kanë zgjedhur.

## KESHILLTARËT E OPOZITËS

Për të sqaruar opinionin publik, ne si këshilltarë të opozitës, kërkuam që të zbatohet një detyrim moral i një vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila kishte konstatuar pavlefshmëri juridike, për 6 mandate këshilltarësh, të cilët nuk kishin kryer betimin në zbatim të ligjit dhe kushtetutës. Për këtë ne kemi kërkuar,

që nuk mund të jemi pjesë e një organi me mandate të pavlefshme, pasi në këtë mënyrë, edhe vendimet tona do të konsideroheshin nul nga gjykatat.

ana e maxhorancës në këshill, për të rikthyer kompetencat e uzurpuara.

**A jeni përpjekur të dialogoni apo të arrini në kompromis me këshilltarët e maxhorancës?**

Ne kemi dialoguar me kolegët e maxhorancës, por kompromis bëjmë vetëm dhe vetëm me zbatimin e ligjit. Askush nuk mund të bëjë kompromis në kundërshtim me ligjin, kushtetutën, dhe interesat e qytetarëve. Ne i kemi kërkuar këshillit të zbatojë vendimet e gjykatave, ose në mbledhjen e fundit, i kërkuam që së bashku të hartojmë një kërkesë drejtuar Kuvendit, për të na rikthyer kompetencat që na njeh ligji, pasi ne besojmë

seky është një problem që prek edhe këshilltarët e maxhorancës dhe jo vetëm të opozitës. Ligji flet për votim të vlefshëm me 3/5, dhe detyrimisht janë këshilltarët e maxhorancës, të cilëve më së shumti iu është mohuar kjo e drejtë që u takon atyre. Ndaj dhe opozita, ka kërkuar që kërkesa të jetë e përbashkët me kolegët e maxhorancës, pasi fare mirë ne mund të bënim një kërkesë vetëm si opozitë, por për ne nuk është e rëndësishme interesi politik apo përfitimi partiak, por zbatimi i ligjit dhe ushtrimit ligjor dhe i pavarur i mandatit të secilit prej anëtarëve të Këshillit Bashkiak.

**Mendonit se braktisja e mbledhjes është zgjidhja**

# DOSJET E SIGURIMIT DOKUMENTET

Zbulohet dokumenti i rrallë ku gjeneral Kolli, informon Hysni Kapon

## Dalin pseudonimet për Peshkopinë: "Besniku", "Rubiku", "Lisi", "Shkencëtari"...

Relacioni sekret: "Nuk janë ndjekur përpunimet ndaj Zija Tafçiu, Jaruk Salihut, Xhedvdet Hunës e Qazim Strazimirit".

Nga Dashnor Kaloci


Nisur edhe nga pozita gjeografike që kishte rrethi i Peshkopisë në veri-lindje të vendit, duke pasur një brez të gjatë të vijës kufitare me shtetin fqinj të ish-Jugosllavisë, edhe vëmendja e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit ishte shumë më e madhe nga rrethet e tjera të vendit që nuk mbartnin atë problematikë që kishin rrethet kufitare. Veç të tjerash kjo gjë bëhet e ditur edhe nga një sërë dokumentesh arkivore me siglën "Tepër Sekret", ku kuadro të lartë të Komitetit Qendror të PPSH-së që mbulonin Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Sigurimin e Shtetit, me ekipe të shumta kanë organizuar kontrolle të herëpashershme në rrethin e Peshkopisë, duke u përqendruar kryesisht në punën e Degës së Brendshme që mbulonte sektorin e Sigurimit të Shtetit dhe rrjetit të saj agjenturor. Lidhur me këtë, bën fjalë dhe raport-informacioni i Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit që mban datën 4 prill 1960, i nënshkruar nga gjeneral-major Rexhep Kolli dhe koloneli Vilosin Pecani, të cilët asokohe punonin në aparatet e Komitetit Qendror të PPSH-së në sektorin e organeve të Diktaturës së Proletariatit, sektor i cili kishte nën vartësi edhe Ministrinë e Brendshme dhe, gjithashtu, Sigurimin e Shtetit. Siç do të shohim nga dokumenti në fjalë, dy kuadrot e lartë të Komitetit Qendror të PPSH-së, në kontrollin që ata kanë bërë pranë Degës së Brendshme të rrethit të Peshkopisë, kanë konstatuar "një sërë të metash dhe dobeshish", kryesisht me rrjetin agjenturor dhe punën e punëtorëve operativë me bashkëpunëtorët e tyre, gjë për të cilën ata kanë informuar menjëherë prorogët e tyre dhe konkretisht, Hysni Kapon, i cili ka vënë edhe shënimi përkatës mbi atë dokument, duke shkruar aty se çfarë udhëzimesh i kishte dhënë Kadri Hazbiut lidhur me problemet që parashtraheshin në atë relacion që publikohet i plotë dhe pa asnjë shkurtim ekskluzivisht për "Gazeta Shqiptare"



Enver Hoxha me Kadri Hazbiu



Zv Ministri i Brendshëm Rexhep Kolli duke dekoruar një kufitar



TETT Tiranë, më 29.4.1960 Nr.

### RELACIONI SEKRET PER GJENDJEN DHE AKTIVITETIN E PUNES SE SIGURIMIT TE RRETHIT PESHKOPI, TE SIGURIM-ZBULIM-KUFIRIT


Prej datës 12.IV.1960 deri me datën 19.IV.1960 u analizua gjendja dhe aktiviteti i punës së Sigurimit në Degën e Punëve të Brendshme Pesh-

kopi dhe konstatuam se:

Gjatë vitit 1959 si dhe në tremujorin e parë të këtij viti, gjendja e punës së Sigurimit në krahasim me vitin 1958 ku u vërtetuan dobësi të mëdha, ka përmirësime të dukshme, të cilat më kryesoret janë:

1. Eshhtë përmirësuar puna me agjenturën, janë bërë rekrutime të reja atje ku nuk ekzistonte, janë rimarrë në lidhje B.P. (bashkëpunëtorët të Sigurimit, shënimi ynë), të përjashtuar, të cilët ishin të nevojshëm dhe janë bërë 12 rekrutime me material kompromentues.

2. Janë arrestuar 15 elementë armiq si rezultat i përpunimeve agjenturore.
3. Eshhtë bërë një punë efektive në drejtim të evitimit të arratisjeve, e cila ka dhënë si rezultat që të ketë shumë më pak arratisje nga vitet e kaluara. Kështu përsëmbull, ndërka në vitin 1958 u arratisën në Jugosllavi 34 persona, në vitin 1959 vetëm 6 persona, kurse këtë vit nuk është arratisur asnjë.
4. Eshhtë përmirësuar metoda e punës



në disa drejtime, si në ndihmë të bazëve, ashtu dhe në sisteminim e evidencave. Por krahas këtyre rezultateve në Sigurimin e rrethit Peshkopi vërehen akoma mjaft dobësi dhe të meta, nga të cilat më të theksuarat janë:

- 1). Duke analizuar problemet e Degës, përpunimet dhe agjenturën, konstatohet se nga gjashtëmujori i dytë dhe këtej, ka një rënie të punës nga

kolektivi i Degës. Kjo rënie pasqyrohet nga fakti se:

- a) Vërtetohen çthurje dhe neglizhenca në drejtim të zbatimit të detyrave nga ana e shumë Punëtorëve operativë dhe mungesë kontrolli e kërkim logarije.

- b) Problemet kryesore të Degës ja kanë lënë Punëtorëve operativë të lokaliteteve të cilët janë të ngarkuar, kurse aparatet (seksionet) që kanë Punëtorë operativë ma me eskpëriencë, janë çliruar pothuajse fare nga përpunimet, të cilët kështjeh kryesore i kanë në terren dhe poshtë dhe jo në qytetin e Peshkopisë. Kështu, shefi i Seksionit të III-të bashkë me dy Punëtorë operativë, nuk ndjekin vetë asnjë përpunime aktive. Në lidhje kanë agjenturë vetëm me informator, pa asnjë agjent. Shefi i Seksionit të I-rë bashkë me dy Punëtorë operativë, ndjekin vetëm tre përpunime aktive. Shefi i Zbulimit të Kufirit, përpunimet e rendësishme ja ka lanë Punëtorit operativ të zonave. Kjo gjëndje spjegohet nga fakti i vetë-kënaqjes për disa rezultate të arritura, e cila ka larguar nga kështjeh kryesore të punës.

Kjo anë shumë negative ka influencuar mjaft në dobësimin e punës agjenturore dhe më e keqja është se nuk është kap dhe vënë në vënd nga udhëheqja e Degës.

- 2). Dega e Brendshme e Peshkopisë ka të dhënë të rëndësishme për vepërimitarisë së punës së armikut, sidomos në drejtim të elementëve që dyshohen plotësisht si agjentë të vënë në shërbim të zbulimit Jugosllav, por

LETRA E DY KUADROVE TE SIGURIMIT PER HYSNI KAPON

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPERISE  
TEPER SEKRET  
MINISTRIA E P. TE  
BRENDESHME  
DREJTORIA E SIGURIMIT TE SH-





Hysni Kajo



Banush Goxhaj

rrethi, Sektori i III-të bën analizën e punës, mbi çfaqjet armiqësore dhe dëmtimet në kooperativat bujqësore dhe në vënd që të nxjerri shkaqet dhe burimet e kësaj veprimtarie nga puna e elementit armik dhe nga dobësit e punës sonë, i nxjerr këto në mënyrë të gabuar si shkak i gabimeve kryesore të kryesisë, organizatave bazë, Komitetit Ekzekutiv dhe Komitetit të Partisë, të cilët nuk i përkasin aspak për të analizuar organetona.

3. U konstatuan raste të shkeljes së platformës së organeve tona. Ja faktet konkrete: Sekretari i Partisë ka aprovuar me shkrim rekrutimin e një rezidenti, strehues dhe disa informator, anëtar partije, që nuk i takon simbas platformës. Rekrutohet para një viti, rezidenti me pseudonimin "Mali",

ikëshme sepse lejon futjen e elementëve armiq në rradhët e agjenturës sonë dhe në materjalet që ata japin, disinformojnë organetona. Efektivisht në rradhët e agjenturës së rrethit të Peshkopisë, vërehen B.P. të dyshimta dhe në pozita armiqësore dhe që nuk janë marrë masa aktive për të sqaruar dhe vendosur mbi pozitën e tyre, siç janë p.sh. B.P. "Benusniku", "Rubiku", "Engjëllushi", "Plepi", "Shkencëtari" etj. Gjithashtu ka edhe B.P. të dekonspiruar të cilët mbahen akoma në rrjetin agjentural. c). Drejtimi agjenturës bëhet në forma të përgjithshme, e cila nuk jep rezultatet e duhura në zbulimin e veprimtarisë së armikut. Gjithashtu u konstatuan raste të pa-

hën kot. Dm.th. nuk e konsideron se takimi është çështje kryesore e punës sonë me agjenturën, se në takim merren me hollësi për detyrat që ka kryer B.P. dhe se i jepen detyrat për në të ardhmen dhe i bëhet edukimi dhe kontrolli mbi punën e saj. Se bazat e takimit janë të pakta dhe kjo ka influencuar negativisht në edukimin e agjenturës. 4) U konstatua se disa nga përpunimet e rëndësishme të Degës dhe të zbulimit të kufirit, janë ngritur nga fundi i vitit 1958 dhe fillimi i vitit 1959, nuk kanë hecur, kjo për faktin se ka munguar dora e fortë e përgjegjësve se një pjesë e agjenturës mirë që ndjek këto përpunime është lënë në dorën e P. operativ.

5) Mjaft plane masash, kanë mbetur pa u zbatuar për arsye nga njëra anë, janë vënë çështje formale dhe nga ana tjetër atje ku detyrat e planit kanë qënë konkrete nuk është ushtruar kontroll sistematik për zbatimin e tyre, madje karakteristikisht është se në një rast një Puntor operativ i Zbulimit të Kufirit arrin të prishtë ndërjegjen duke kopjuar datën e planit të vitit 1959, në vitin 1960 për ta paraqitur veten në rregull. Gjithashtu vërehet mungesa e bashkëpunimit të ngushtë midis Puntorit operativ të lokaliteteve dhe atyre të Zbulimit të Kufirit, sidomos në mos organizimin e mirë të përpunimeve dhe të lidhjeve të tyre që u takojnë të dy planeve, si dhe në mosshfrytëzimin efektiv të agjenturës për objektet e njëri tjetrit kur këto lidhen me njëri tjetrin.

6) Në shumë drejtime të metat dhe dobësitë dalin të përsëritura nga vitet e kaluara. Bashkimi i këtyre dobësive dhe të metave japin një pasqyrë të qartë ku gjënda agjenturore operative në rrethet e Peshkopisë është akoma e dobët. Sipas mendimit tonë, organizata bazë e Partisë nuk e ka luajtur rolin e saj në shkallën e duhur për forcimin e gjithanshëm të punës si dhe për të luftuar dobësitë dhe të metat e komunistëve në Degën e Peshkopisë. Madje mund të thuhet se ajo jo vetëm nuk është marrë siç duhet me problemet që i takojnë, por edhe me çështje që dëmtojnë sekretin e punës p.sh., Byroja e organizatës merr në analizë në detaje punën e një Puntori operativ të lokalitetit, këtu është për të vënë

fatëkeqësisht këto të dhëna në shumë raste nuk janë ndjekur sistematikisht me masa agjenturale operative, duke munguar dora e përgjegjësive.

Kështu p.sh. nuk janë ndjekur aktivisht përpunimet në drejtim të Zija Tafçit, Jaruk Salihut, Xhedvdet Hunës, Qazim Strazimirit, e të tjerë.


Mos ndjekja në mënyrë aktive e të dhënave të agjenturës, e përpunimeve agjenturale, e zbatimit të planit të masave, ka bërë atë që të mos njihet veprimtaria e armikut në shkallën që kërkohet, sidomos e Zbulimit Jugosllav.

Gjithashtu duke mos ndjekur dhe njohur si duhet veprimtarinë e armikut në drejtim të kooperativave bujqësore, duke mos pasur asnjë përpunim aktiv në drejtim të 76 kulakëve të këti

per te shqyrtuar e vendosur shtu pozitën e tyre si: Jona p.sh. B.P. "Bashki ku", "Hudina", "Dagjellushi", "Plepi", "Shkencëtari", "Plepi". Gjithashtu ka edhe B.P. të dekonspiruar të cilët mbahen akoma në rrjetin agjentural. c). Drejtimi i agjenturës bëhet në forma të përgjithshme, e cila nuk jep rezultatet e duhura në zbulimin e veprimtarisë së armikut. Gjithashtu u konstatuan raste të shkeljes së platformës së organeve tona. Ja faktet konkrete: Sekretari i Partisë ka aprovuar me shkrim rekrutimin e një rezidenti, strehues dhe disa informator, anëtar partije, që nuk i takon simbas platformës. Rekrutohet para një viti, rezidenti me pseudonimin "Mali", i cili deri në momentin që ishte ekipi, i pa aprovuar nga Kryesia e Degës. Ky resident i pa aprovuar, mban lidhje me 6 informatorë. Janë rekrutuar mbi baza patriotike, dy B.P. ("Referi i vogël" dhe "Lisi") për të cilët kishte material se zhvillimin propagandë armiqësore. Disa B.P. janë rimarrë në lidhje pa vendim simbas platformës. Të gjitha këto rregojnë se nuk është mbajtur parasysh platforma në të gjithë punën tonë të përditshme. Mbi agjenturën Mos zbulimi në shkallën e duhur të veprimtarisë armiqësore në rrethet e Peshkopisë, e kanë

burimin të puna e dobët që bëhet nga ana e Punëtorëve operativ me agjenturën. Mbi punën me agjenturën konstatohen këto dobësitë: a). Nga mungesa e studimit të materjaleve të agjenturës nga Punëtori operativ, si dhe nga vetë përgjegjësit, janë bërë edhe rekrutime pa princip dhe qëllime të caktuar, sidomos rekrutime të tilla gjen në qytetin e Peshkopisë, të cilat kanë shtuar numrin e lidhjeve. Ja p.sh., në planin e Degës për Sektorin e III-të vihet për të rekrutuar 3 B.P. në kooperativën e berberëve, pa qenë aspak nevojta. Në qytetin e Peshkopisë numërohen 47 B.P. që mbahen në lidhje, plus 25 që ka Policija. Numri është mjaft i madh dhe që nuk kanë drejtim të caktuar. Këto çfaqje të shumta kanë dobësuar punën në drejtim konkret. b). Konstatohen raste të besit të tepërta mbi agjenturën nga ana e Punëtorëve operativ. Kjo ka shkakuar që kontrolli mbi agjenturën, verifikimi i të dhënave të saj, të jetë i dobët. Një mungesë e tillë është shumë e rrez-

burimin të puna e dobët që bëhet nga ana e Punëtorëve operativ me agjenturën. Mbi punën me agjenturën konstatohen këto dobësitë: a). Nga mungesa e studimit të materjaleve të agjenturës nga Punëtori operativ, si dhe nga vetë përgjegjësit, janë bërë edhe rekrutime pa princip dhe qëllime të caktuar, sidomos rekrutime të tilla gjen në qytetin e Peshkopisë, të cilat kanë shtuar numrin e lidhjeve. Ja p.sh., në planin e Degës për Sektorin e III-të vihet për të rekrutuar 3 B.P. në kooperativën e berberëve, pa qenë aspak nevojta. Në qytetin e Peshkopisë numërohen 47 B.P. që mbahen në lidhje, plus 25 që ka Policija. Numri është mjaft i madh dhe që nuk kanë drejtim të caktuar. Këto çfaqje të shumta kanë dobësuar punën në drejtim konkret. b). Konstatohen raste të besit të tepërta mbi agjenturën nga ana e Punëtorëve operativ. Kjo ka shkakuar që kontrolli mbi agjenturën, verifikimi i të dhënave të saj, të jetë i dobët. Një mungesë e tillë është shumë e rrez-



Pjestari i Forcave të Kufirit së bashku me malësor gjatë një patrullimi. Foto e viteve 60-70

burimin të puna e dobët që bëhet nga ana e Punëtorëve operativ me agjenturën. Mbi punën me agjenturën konstatohen këto dobësitë: a). Nga mungesa e studimit të materjaleve të agjenturës nga Punëtori operativ, si dhe nga vetë përgjegjësit, janë bërë edhe rekrutime pa princip dhe qëllime të caktuar, sidomos rekrutime të tilla gjen në qytetin e Peshkopisë, të cilat kanë shtuar numrin e lidhjeve. Ja p.sh., në planin e Degës për Sektorin e III-të vihet për të rekrutuar 3 B.P. në kooperativën e berberëve, pa qenë aspak nevojta. Në qytetin e Peshkopisë numërohen 47 B.P. që mbahen në lidhje, plus 25 që ka Policija. Numri është mjaft i madh dhe që nuk kanë drejtim të caktuar. Këto çfaqje të shumta kanë dobësuar punën në drejtim konkret. b). Konstatohen raste të besit të tepërta mbi agjenturën nga ana e Punëtorëve operativ. Kjo ka shkakuar që kontrolli mbi agjenturën, verifikimi i të dhënave të saj, të jetë i dobët. Një mungesë e tillë është shumë e rrez-

burimin të puna e dobët që bëhet nga ana e Punëtorëve operativ me agjenturën. Mbi punën me agjenturën konstatohen këto dobësitë: a). Nga mungesa e studimit të materjaleve të agjenturës nga Punëtori operativ, si dhe nga vetë përgjegjësit, janë bërë edhe rekrutime pa princip dhe qëllime të caktuar, sidomos rekrutime të tilla gjen në qytetin e Peshkopisë, të cilat kanë shtuar numrin e lidhjeve. Ja p.sh., në planin e Degës për Sektorin e III-të vihet për të rekrutuar 3 B.P. në kooperativën e berberëve, pa qenë aspak nevojta. Në qytetin e Peshkopisë numërohen 47 B.P. që mbahen në lidhje, plus 25 që ka Policija. Numri është mjaft i madh dhe që nuk kanë drejtim të caktuar. Këto çfaqje të shumta kanë dobësuar punën në drejtim konkret. b). Konstatohen raste të besit të tepërta mbi agjenturën nga ana e Punëtorëve operativ. Kjo ka shkakuar që kontrolli mbi agjenturën, verifikimi i të dhënave të saj, të jetë i dobët. Një mungesë e tillë është shumë e rrez-

burimin të puna e dobët që bëhet nga ana e Punëtorëve operativ me agjenturën. Mbi punën me agjenturën konstatohen këto dobësitë: a). Nga mungesa e studimit të materjaleve të agjenturës nga Punëtori operativ, si dhe nga vetë përgjegjësit, janë bërë edhe rekrutime pa princip dhe qëllime të caktuar, sidomos rekrutime të tilla gjen në qytetin e Peshkopisë, të cilat kanë shtuar numrin e lidhjeve. Ja p.sh., në planin e Degës për Sektorin e III-të vihet për të rekrutuar 3 B.P. në kooperativën e berberëve, pa qenë aspak nevojta. Në qytetin e Peshkopisë numërohen 47 B.P. që mbahen në lidhje, plus 25 që ka Policija. Numri është mjaft i madh dhe që nuk kanë drejtim të caktuar. Këto çfaqje të shumta kanë dobësuar punën në drejtim konkret. b). Konstatohen raste të besit të tepërta mbi agjenturën nga ana e Punëtorëve operativ. Kjo ka shkakuar që kontrolli mbi agjenturën, verifikimi i të dhënave të saj, të jetë i dobët. Një mungesë e tillë është shumë e rrez-

Kolonel Gjeneral-majror (Wilson Pecani) (Rexhep Kolli)



2500 garues nga 40 vende të botës për edicionin e tretë të garës

Pamela Aliaj

Është kthyer tashmë në traditë dhe, siç çdo vit, edhe këtë vit është zhvilluar Maratona e Tiranës. Ka qenë pikërisht ditën e djeshme dita kur është realizuar maratona e edicionit të tretë në Tiranë për vitin 2018. Menjëherë pas garës së vrapit janë shpallur fituesit për garën 21 km në Maratonën e Tiranës, në të cilën morën pjesë rreth 2500 garues nga 40 vende të botës. Mësohet se fitues nga meshkujt është Abel Kibet Rop nga Kenia, ndërsa nga femrat është shqiptarja Luiza Gega. Ndërkohë që Nelson Kipkoge Kerutich nga Kenia dhe Ruth Nundu Mbatha po nga Kenia ishin fituesit e garës në kategorinë "Tirana 10K", prej 10 km. Kerutich arriti të fitoi garën e 10 km për meshkuj duke e përsëruar gjithë itinerarin për 32 minuta e 31 sekonda, Mbatha fitoi garën për femra duke përsëruar 10 km për 36 minuta e 46 sekonda. Fitues i garës i garës për personat më aftësi të kufizuara, "we too" u shpall Bledar Suxha. Ndërkaq për këtë garë bashkia bëri të mundur që, ndryshe nga dy



Luiza Gega, Fituesja e maratonës

edicionet e kaluara, maratona e këtij viti të përshkonte edhe disa nga pikat më tërheqëse dhe panoramike të Tiranës, siç është pjesa përrreth Liqenit Ar-

tificial. Të shtunën dhe të dielën pati kufizim të qarkullimit të automjeteve në disa segmente rrugore, ku kaloi Maratona e Tiranës. Për garën e madhe të

# Maratona e Tiranës, atletja Luiza Gega rrëmben kupën

## 21 km, 10 km dhe "we too", fituesit për çdo kategori

### FITUESIT E MARATONËS SË TIRANËS 2018:

#### ♦ Kategoria Half Marathon (21, 0975 km)

##### Femra 21 km:

Vendi i I - Luiza Gega (Shqipëri) 01: 14' 18"

Vendi i II - Agnes Chebet (Kenia) 01: 14' 56"

Vendi i III - Christine Moraa Oigo (Kenia) 01: 15' 59"

##### Meshkuj 21 km:

Vendi i I - Abel Kibet Rop (Kenia) 01: 05' 13"

Vendi i II - Hosea Kiplagat Tui (Kenia) 01: 05' 45"

Vendi i III - Evans Kipngetch Tanui (Kenia) 01: 07' 12"

#### ♦ Kategoria "Tirana 10K"

##### Femra 10 km:

Vendi i I - Ruth Nundu Mbatha (Kenia) 00: 36' 41"

Vendi i II - Hellen Jepkosgei Kimutai (Kenia) 00: 37' 19"

Vendi i III - Zita Kecser (Hungari) 00: 38' 10"

##### Meshkuj 10 km:

Vendi i I - Nelson Kipkoge Kerutich (Kenia) 00:32' 31"

Vendi i II - Mathew Kosgei (Kenia) 00: 32', 59"

Vendi i III - Moses Kipruto Kibire (Kenia) 00:33' 20"

#### ♦ Kategoria "we too"

Vendi i I - Bledar Suxha (Shqipëri) 00:12' 00"

Vendi i II - Erblin Karaj (Shqipëria) 00: 12' 08"

Vendi i III - Dovlet Xhangolli 00:12' 17"

së dielës, pjesë e planit të masave organizuese për mbarëvajtjen e maratonës ishte ndalimi i qarkullimit në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", rrugët "Abdi Toptani", "George W. Bush", "Rruga e Barrikadave", "Urani Pano", "Ded Gjo Luli", "Rruga e Kavajës" deri te kisha "Katolike" dhe kthim, "Ibrahim Rugova", "Lek Dukagjini", si dhe segmentet hyrëse rruga "Myslym Shyri" nga kryqëzimi i Drejtorisë së Policisë deri në qendër, "Rruga e Durësit" nga kryqëzimi me rrugën "Mine Peza" deri në qendër, Bulevardi "Zogu I" nga rruga "Dervish Hatixhe" deri në qendër, "Rruga e Dibrës" nga "Selvia" deri në qendër, rruga "Luigj Gurakuqi" nga sheshi "Avni Rrustemi" deri në qendër, në datën 07 Tetor 2018, a nga ora 05:00 deri në orën 14:00.

## Mjekë!

## Kujdesuni të siguronit jetën tuaj

përpara se të kujdeseni për shëndetin e pacientëve!

Me Sigurimin Jetë me Mbijetesë keni përfitim dyfish: sigurim jete dhe investim afatgjatë. Mbroni pasardhësit tuaj në rast të të papiturave dhe njëkohësisht investoni me një normë të garantuar interesi prej 1.2% në vit, në monedhat Lek, Euro ose Dollar. Primi vjetor minimal duke filluar nga 200 euro/vit dhe shumë sigurimi deri në 120,000 euro!



Sigurim për Jetën



Sigurim nga Aksidentet



Sigurim nga Sëmundjet Kritike

**SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete

Për të blerë policën, kontaktoni me SiCRED në: Tel: +355 4 22 37 549 | Cel: +355 69 20 84 026 | e-mail: shitje@sicred.com.al





## MUAJI I NDËRGJEGJËSIMIT



Kanceri i gjirit,  
shenjat kryesore  
dhe mënyrat  
e diagnostikimit

## Ylli Merja:



◆ Mjeku popullor:  
Kujdes, marrja  
e antibiotikëve  
për shumë kohë  
përbën rrezik

## KESHILLA



Çajrat  
bimorë që  
pastrojnë  
stomakun tuaj

## Si të kuroni mykun me bimë mjekësore

"Përdorni rignonin e bardhë  
dhe mushmollën

• 7 kura natyrale në kushte shtëpie

Mjeku popullor: Kujdes, marrja e antibiotikëve për shumë kohë përbën rrezik

# Ylli Merja:

## Si të kuroni mykun me bimë mjekësore

"Kujdes, mos harroni të vaksinoheni kundër gripit"

Voltiza Duro

Myku është një lloj in feksioni që shkaktohet nga disa kërpudha dermatofite, që infektjnë më shumë flokët, thonjtë dhe lëkurën. Ndërsa mikrospotum ku paraqiten rreth 17 lloje më shumë infektjnë lëkurën dhe thonjtë. Në përgjithësi myku mund të përfitohet nga kërpudhat dermatofite që transmetohen nga njeriu te njeriu, pra një person i infektuar me myk mund të infekttojë edhe persona të tjerë. Kërpudhat dermatofite zoofile ku transmetohet sporja e kërpudhës nga kafsha te njeriu. Më i përhapur është myku i bardhë dhe ato lloje myqesh që mund të shfaqen në organizëm nga përdorimi i gjatë i antibiotikëve.

### FAKTORËT

Një ndër shkaktarët kryesorë në krijimin e mykut është përdorimi i gjatë i kurave me antibiotikë. Por edhe një kafshë e infektuar nga myku në lëkurë mund të transmetojë sporet e kërpudhave te një njeri, dhe ky i fundit mund të infekttojë persona të tjerë. Në përgjithësi kur sporet kërpudhore bien në trupin e njeriut apo në brendësi të tij, ato kanë aftësinë që të ulin pH e lëkurës, pra nga një peash bazik e zbresin atë, e krijohet një mjedis acid, i favorshëm për zhvillimin e kërpudhave. Nga kjo sëmundje preken njerëz të profesioneve të ndryshme, por më të predispozuar janë ata, të cilët kanë rezis-

tencë të ulët të organizmit. Krijohet një lagështirë mes gishtave të këmbës, te thembrat, te pjesa pas kupës së gjurit, e te femrat shfaqet edhe poshtë gjoksit. Por mund të shfaqet edhe poshtë sqetullave e mes gishtave të dorës. Pra, këto janë vendet më të prekura. Që të zhvillohet myku, kërkohet një temperaturë të përshtatshme si dhe lagështirën e nevojshme. Moshat më të predispozuar për t'u prekur nga myku janë në përgjithësi femijët që marrin antibiotikë për një kohë të gjatë, edhe femrat. Një grup



tjetër i prekur janë të gjithë ata persona që mbajnë këpucë të veshura për një kohë të gjatë.

### DIAGNOSTIKIMI

Në përgjithësi personat që janë prekur nga myku shfaqin shenja anemi, kanë gojë të thatë e gjuhë të zbardhur. Në këto raste mendojnë se ky person është

prekur nga myku në brendësi të organizmit ku më i mundshmi është myku i bardhë. Shpeshherë këta njerëz bëhen alergjikë, kanë kruarje të trupit, puçra e harta në trup. Pra, kërpudhat pasi janë vendosur në organizëm, arrijnë që të marrin nga njeriu kripërat minerale dhe sheqernat duke e dobësuar atë. Në momentin që myku zhvillohet shumë, atëherë njeriut i shfaqen fryrje zorrësh e diarre të shpeshta e trupit kërkohet të vetëpastrohet e të nxjerrë jashtë këta trupa të huaj që lulëzojnë në organizëm. Ndërsa, ka raste kur shkakton edhe çarje të lëkurës e sporet e kanë më të lehtë për t'u shumuar në këtë mënyrë. Pra kur vendosen në këmbë, duar, lëkurë, flokë, fillojnë të japin problematika serioze si kruarje rrjedhje dhe përhapje në formën e rratheve koncentrike apo në formë të çrregullt. Personat që preken nga myku pëlqejnë shumë ushqimet e ëmbla të pasura me sheqer.

### TRAJTIMI ME BIMË MJEKËSORE

Bimët më të fuqishme mjekësore antimykotike që mund të përdorë njeriu janë rizoni i bardhë, i cili gjendet që nga Shqipëria e Mesme deri në Jug të vendit; trumza me përhapje të gjerë në vend; gjethe e mushmollës pasi kanë një



Mjeku popullor Ylli Merja

push të bardhë të ngjashëm me atë të mykut; gjethe e ftoit; dëllinja, kalendula etj. Për ta luftuar mykun në organizëm, kur ne e kemi diagnostikuar me një kulturë mykotike në laborator apo nga mjeku, duhet të veprimë kështu: Kur myku është në sipërfaqe, lëkurë gjoks duhet të shpëllajmë zonën e infektuar me një çaj antimykotik të përgatitur me bimët e

rregullator i peashit në sipërfaqen e trupit, pra t'i afrohem një mjedisi neutral apo bazik. Pasi të thahet çaji, është mirë që të pikojmë mbi vendet ku ndodhet myku, propolisin në laborator apo nga mjeku, duhet të veprimë kështu: Kur myku është në sipërfaqe, lëkurë gjoks duhet të shpëllajmë zonën e infektuar me një çaj antimykotik të përgatitur me bimët e



mësipërme, 1-2 herë në ditë e është mirë që në çdo gotë çaji të hedhim një lugë kafe me sodë buke. Kjo e fundit në këtë rast përdoret si një

pudhave, kthehen në gjendje gjumi e qëndrojnë si të strukturata në rrenjë e qimeve derisa njeriu mendon se është shëruar plotësisht. Por në momentin që shfaqet një habitat i përshtatshëm e nuk luftohen më, arrijnë të zhvillohen sërisht. Prandaj trajtimi duhet për më tepër se një muaj. Në rastet kur myku ndodhet në brendësi të organizmit, i sëmuri duhet që në mëngjes të shpëllajë gojën mirë me sodë buke e mjalte. Në këtë mënyrë sigurojmë një nxjerrje jashtë organizmit të kërpudhave që kanë mbirë në gojë gjatë natës. Pas kësaj, bëjmë një shpëllarje të mirë të gojës me ujë të bollshëm e pimë një gotë çaj antimykotik.





Tetori, në të gjithë botën është muaji i ndërgjegjësimit për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit është një fushatë vjetore ndërkombëtare që synon të shpërndajë informacion dhe të edukojë njerëzit për rëndësinë e shëndetit të gjirit, për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit te gratë dhe vajzat në të gjithë botën. Më poshtë po sjellim disa informacione të vlefshme nga Instituti i Shëndetit Publik mbi diagnostikimin dhe kurimin e sëmundjes.

#### Çfarë është kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit është një sëmundje ku qelizat e gjirit rriten jashtë kontrollit. Kanceri i gjirit mund të fillojë në pjesë të ndryshme të gjirit dhe mund të përhapet jashtë tij nëpërmjet enëve të gjakut dhe enëve limfatike, pra duke dhënë metastaza. Të dy seksat, si gratë ashtu edhe burrat mund të preken nga kanceri i gjirit, edhe pse ky kancer është shumë më i zakonshëm te gratë. Disa gra janë në rrezik më të lartë për kancerin e gjirit sesa disa të tjerë për shkak të historisë së tyre mjekësore, personale, familjare, ose për shkak të ndryshimeve të caktuara gjenetike.

#### Përhapja

Bazuar në të dhënat e Agjencisë Ndërkombëtare mbi Kërkimet mbi Kancerin në Botë (GLOBOCAN), e cila përllogarit një vlerësim të situatës reale në çdo vend të botës, kanceri i gjirit ka incidencën më të lartë ndër llojet e kancerit që prekin gratë kudo në botë. Pjesa më e madhe e vdekjeve nga kanceri i gjirit ndodh në vendet me të ardhura të ulëta e mesatare, ku shumica e grave me kancer gjiri diagnostikohen në faza të vonshme. Kanceri i gjirit prek të gjitha gratë, por rreziku rritet me rritjen e moshës. Përgjithësisht preken moshat mbi 50 vjeç, por kanceri i gjirit mund të shfaqet edhe në moshë fare të reja.

Studimet kanë treguar se rreziku për kancerin e gjirit është rezultat i një kombinimi faktorësh. Disa nga faktorët e rrezikut përfshijnë:

Mosha-rreziku rritet me rritjen e moshës; Ndryshimet në disa gjene, deri 10% e kancereve të gjirit janë si rezultat i një defekti gjenetik; Fillimin e hershëm të menstruacioneve; Fillimin e menopauzës pas moshës 55 vjeç; Shtazënitë në moshë të madhe ose moslindjen e fëmijëve; Mungesën e aktivitetit fizik; Të qenit mbipeshë apo obeze pas menopauzës; Indi i gjirit i ngjeshur/i dendur; Historitë personale me kancer gjiri-femrat që kanë pasur kancer gjiri kanë më shumë gjasa për t'u prekur përsëri nga kanceri i gjirit; Historitë familjare me kancer gjiri; Alkoolpirjen dhe pirjen e duhanit. Nëse një grua ka faktorë rreziku për kancer gjiri, ajo duhet të flasë me mjekun lidhur me mënyrat që mund të ulin rrezikun, si dhe kontrollat



## Kanceri i gjirit, shenjat kryesore dhe mënyrat e diagnostikimit



që duhen bërë.

#### Simptomat dhe diagnostikimi

Njerëz të ndryshëm kanë shenja të ndryshme të kancerit të gjirit. Por, disa të tjerë nuk kanë shenja fare dhe mund ta konstatojnë kancerin e gjirit vetëm pas një mamografie rutinë. Ekzistojnë disa mënyra kontrolli për gjirin si: Vetëkontrolli mujor i gjirit; Ekzaminimi klinik i gjirit nga një personel shëndetësor; Mamografia; Eko e gjirit.

#### Si trajtohet kanceri i gjirit

Kanceri i gjirit është ndër

llojet e kancerit pothuajse tërësisht i trajtueshëm. Kanceri i gjirit trajtohet në disa mënyra si: ndërhyrjet kirurgjike, kimioterapia, terapia hormonale, terapia me rrezatim. Mënyra e trajtimit varet nga lloji i kancerit të gjirit dhe se sa është i përhapur ai. Njerëzve me kancer të gjirit shpesh u duhet të marrin më shumë se një lloj të trajtimit.

Fatmirësisht, pothuajse të gjitha mënyrat e trajtimit bashkëkohor ofrohen edhe në Shqipëri. Së fundi kanë hyrë edhe preparate të cilat rrisin jetëgjatësinë për pacientët në faza të avancuara. Trajtimet e reja

#### DISA SHENJA QË MUND TË JENË TREGUES TË KANCERIT TË GJIRIT

- Një gjëndër apo një kokërr në gji ose nën sqetull. Shumë faktorë mund të shkaktojnë gjëndra në gjoks duke përfshirë edhe kancerin, por jo çdo gjëndër në gji është kancer.
- Trashje ose ënjtje e një pjese të gjirit.
- Ndryshime të lëkurës së gjirit-skuqje, plagë apo dëmtime të tjera të lëkurës së gjirit.
- Skuqje, çarje apo trashje e lëkurës përreth thithit të gjirit, gropëzim i thithit të gjirit.
- Rrjedhje nga gjiri përveç qumështit të gjirit, duke përfshirë edhe gjakun.
- Çdo ndryshim në madhësinë apo formën e gjirit.
- Dhimbje në gji.
- Fryrje apo ënjtje e krahut nga njëra anë-disa herë kanceri i gjirit mund të përhapet edhe në gjëndrat limfatike nën krah dhe të shkaktojë fryrje apo ënjtje të tij. Prandaj, gjëndrat limfatike të ënjtura duhen konsideruar një shenjë e mundshme e kancerit të gjirit.
- Çdo ndryshim tjetër i pazakontë në gji.

vonojnë progresin e sëmundjes shumë më mirë se preparatet e deritanishme, duke ofruar një mundësi të re për pacientët.

#### Çfarë është kujdesi paliativ

Kujdesi paliativ është trajtimi gjithëpërfshirës për personat, të cilët vuajnë nga sëmundje që janë kërcënuese për jetën (si kanceri i gjirit në këtë rast). Kujdesi paliativ trajton vuajtjen fizike nga sëmundja, si dhe çështjet që lidhen me të drejtën njerëzore për të patur një fund sa më cilësor të jetës

në të gjitha aspektet si fizike, sociale, psikologjike e shpirtërore. Kujdesi paliativ nuk kufizohet vetëm në kujdesin ndaj të sëmurit por edhe në nevojat e familjarëve. Në Shqipëri ekzistojnë shërbime të kujdesit paliativ publik dhe jopublik që u shërbejnë të sëmurëve në shtëpi në faza të avancuara me kancer gjiri. Këto shërbime janë të pajisura me staf multidisiplinar të trajnuar për të ofruar shërbim cilësor.

# Këshilla

## Çajrat bimore që pastrojnë stomakun tuaj

**N**donjëherë një regjim i gabuar ushqimor mund të shkaktojë jo vetëm inflamacion, por edhe të nxisë akumulimin e toksinave. Pankreasi është një prej organeve që vuan më shumë pasojat e toksinave dhe është përgjegjës për prodhimin e acideve të stomakut që mundësojnë tretjen e ushqimeve që hamë. Pankreasi prodhon insulinë dhe ndihmon të rregullojë nivelin e sheqerit në gjak e falë tij, njeriu arrin të shmangë diabetin. Bimë mjekësore për shëndetin e stomakut dhe pankreasit është çaji jeshil, një antioksidant natyral. Konsumi ditëri i tij përmirëson shëndetin e stomakut dhe pankreasit. Ky çaj përmban një substancë të njohur si EGCG që parandalon formimin dhe shumimin e qelizave tumoriale. Çajin jeshil e gjeni në supermarkete dhe farmaci.

Gjysmë luge çaj jeshil pluhur ziejeni në një gotë ujë. Pini një gotë në ditë. Personat me tension të ulët duhet të kenë kujdes me sasinë.

Edhe çaji i jamballit është i pasur me substanca që mbajnë nën kontroll glukozën në nivel qelizor. Ato luftojnë inflamacionin dhe shërojnë pankreasin, por ky çaj rekomandohet edhe për rezistencën ndaj insulinës. Një luge çaji gjethe jamballi ziejeni në një gotë ujë. Pijeni një gotë në ditë për rreth 20 ditë. Çaj rozmarinë dhe sherebele i kombinuar përkujdeset për shëndetin e



pankreasit si dhe qetëson muskujt dhe nxit gjumin. Rozmarina në veçanti lufton inflamacionin dhe pastron pankreasin. Zieni një tufë rozmarinë me pesë gjethe sherebele, shtoni mjaltë dhe pijeni rregullisht çdo ditë për rreth një muaj.

Çaji i gjembgomarit përmban silimarinë, një substancë që ndihmon në shërimin dhe rimëkëmbjen e mëlçisë dhe pankreasit. Kjo substancë shërben si antioksidant

dhe stimulon zhvillimin e qelizave të reja të mëlçisë dhe pankreasit. Gjembgomarit zakonisht bëhet pjesë e shumë terapi bimore pas-truese për organet. Zieni një luge gjelle me gjethe të thara gjembgomarit në një çajnik me ujë. Pasi të ketë zier, lëreni mënjatë të ftohet dhe çajin mund ta pini pas vakteve. Gjembgomarin mund ta konsumoni edhe si kapsulë në një sasi prej 450 mg, por vetëm nëse rekomandohet nga mjeku.



## 7 kura natyrale në kushte shtëpie

Shumë probleme të vogla shëndetësore mund të zgjidhen dhe kurohen lehtë në kushte të shtëpisë. Zgjidhjet dhe kurat që rekomandohen më poshtë janë tërësisht natyrale.

### VAJI I MËLÇISË SË MERLUCIT KUNDËR INFLAMACIONIT

Vaji i mëlçisë së merlucit është përdorur prej shumë kohësh kundër dhimbjeve të artritit. Ai është shumë i pasur me acide yndyrore omega-3 të cilat mbështesin shëndetin e zemrës, trurit, syve. Ky vaj është shumë efikas kundër inflamacionit që shërben si pikënisje e shumë sëmundjeve. Gjetet edhe në farmaci si suplement.

### AKULLI KUNDËR DHIMBJEVE TË KOKËS

Ekspertët e mjekësisë tradicionale mbështesin idenë se aplikimi i kompresës së ftohtë me akull në qafë apo mbi arteriet për rreth saj zbut dhimbjet e migrenës.

### ZBARDHJA E DHËMBËVE ME SODË BUKE

Nëse dëshironi dhëmbë të bardhë, zbardhini ato me sodë buke.

Me të, ju mund të përgatitni një pastë duke e zbutur në ujë dhe më pas fërkuar dhëmbët.

Megjithatë, përdorimi i tepërt i kësaj kure mund të gërryjë enaminin. Kujdes me sasinë. Këtë metodë nuk duhet ta bëni çdo ditë.

### Vitamina C kundër alergjive

Vitamina C nuk bën mirë vetëm kundër të ftohurës. Vitamina C në variantin spërkatës zhbllokon më shpejt hundët e zëna si pasojë e alergjive.

### ASPIRINA KUNDËR KALLOVE

Merrni pesë ose gjashtë aspirina dhe shtypini deri sa të bëhen pluhur.

Më pas shtoni gjysmë luge çaji me lëng limoni dhe gjysmë luge çaji me ujë. Përziejini mirë deri sa të formoni një pastë të cilën më pas mund ta vendosni mbi kallo. Mbështillenit zonën me një qese plastike dhe më pas me një peshqir të ngrohtë. Më pas për pastrimin e pastës së tharë përdorni një limë për fërkimin e këmbëve. Kjo kurë nuk rekomandohet për njerëzit që janë alergjikë ndaj aspirinës.

### ÇAJI I TRUMZËS KUNDËR KOLLËS

Trumza qetëson rrugët e frymëmarrjes dhe shpërbën sekrecionet. Çaji i saj rekomandohet fort nga ekspertët kundër kollës. Ju mund të zieni dy luge gjelle me trumzë të freskët në ujë. Më pas çajin ta ëmbëlsoni me mjaltë për një efekt të dyfishtë.

### ÇAJI I MANAFERRËS KUNDËR DIARESË

Manaferrat janë të pasura me substanca ngushtuese të sistemit të tretës. Ato janë përdorur gjithmonë si një trajtim efikas kundër diaresë. Çaji i manaferrës përgatitet duke zier manaferra të freskëta ose të thata në ujë për 10 minuta. Çajin mund ta pini disa herë në ditë.



## LOTARIA AMERIKANE HAPAT

"Aplikimi online për regjistrimin është i thjeshtë dhe është falas. Më të favorizuarit"

Voltiza Duro

Pasditen e së mërkurës kanë nisur aplikimet për Lotarinë Amerikane për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar. Përmes një njoftimi në faqen e saj zyrtare, ambasada amerikane në Tiranë ka dhënë disa këshilla të vlefshme për mënyrën e aplikimit dhe procedurën që duhet ndjekur. Në njoftim theksohet se plotësimi i formularit është falas dhe nuk ka asnjë pagesë, ndërsa iu bëhet thirrje të interesuarve që të vizitojnë faqen e dedikuar për më shumë detaje. "Lotaria Amerikane është FALAS dhe nuk ka asnjë pagesë për të dërguar formularin tuaj të aplikimit. Plotësoni aplikimin tuaj në state.gov. Vizitoni faqen tonë të internetit dhe lexoni në shqip udhëzimet e Lotarisë Amerikane për këtë vit", thekson ambasada. Më tej kjo e fundit bën thirrje për kandidatët që ka faqe interneti mashtruese që kërkojnë para. "Bëni kujdes nga mashtrimet. Disa faqe interneti apo emaile përpqen t'ju mashtrorin duke u prezantuar si faqe zyrtare të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Lexoni Kujdesin ndaj mashtrimit. Plotësojeni vetë aplikimin tuaj. Aplikimi online për regjistrimin për lotarinë është i thjeshtë dhe është falas", paralajmëron ambasada.

### DV-2020

Programi i Vizave Emigruese të Shumëllojshmërisë, i autorizuar nga Kongresi, administrohet nga Departamenti i Shtetit në bazë vjetore. Seksioni 203(c) i Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë (INA) mundëson viza për një grup "emigrantësh të shumëllojshmërisë", prej vendeve me shkallë historikisht të ulët emigrimi në Shtetet e Bashkuara. Për vitin fiskal 2020, do të jenë në dispozicion 50,000 viza emigrantësh të shumëllojshmërisë (DV). Regjistrimi për në programin e Lotarisë është falas. Aplikantët që janë përgjegjdhur nga programi i lotarisë ("të përgjegjdhurit") duhet të plotësojnë kërkesa të thjeshta, por të rrepta, të pranueshme në mënyrë që të kualifikohen për një vizë shumëllojshmërie. Një kompjuter përzgjedh rastësisht aplikantët për vizën e lotarisë. Vizat e lotarisë shpërndahen ndërmjet gjashtë rajoneve gjeografike dhe asnjë vend i veçantë nuk mund të përfitojë më shumë se 7% të Lotarive (DV-ve) të disponueshme për çdo vit.

# Ëndrra amerikane, ambasada: Kujdes, mos bini pre e mashtrimeve

"Ja ku duhet ta plotësoni aplikimin tuaj për të mos gabuar"



Ambasada e SHBA në Tiranë

### KERKESAT PER APLIKIM

Çdo aplikant duhet të plotësojë ose kërkesën e arsimit ose kërkesën e përvojës së punës të programit të lotarisë, duke poseduar një arsimim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij, përkufizuar si përfundim me sukses i 12 viteve edukim të plotë zyrtar 9-vjeçar dhe i mesëm; ose të ketë dy vjet përvojë pune brenda pesë viteve të kaluara në një punësim që kërkon të paktën 2 vjet trajnim ose eksperiencë për ta ushtruar. "Për të përcaktuar nëse përvoja e punës kualifikohet për lotarinë, do të përdoret Baza e të Dhënave të Departamentit Amerikan të Punës O\*Net OnLine.

Për "Lotarinë DV-2020, vendasit e shteteve të mëposhtme nuk janë të ligjshëm për të aplikuar, pasi këto shtete kanë dërguar në total më shumë se 50,000 emigrantë në SHBA në pesë vitet e shkuara: Bangladesh, Brazil, Kanada, Kinë (të lindurit në kontinent), Kolumbi, Republika Domenikane, San Salvador, Haiti, India, Xhamaika, Meksikë, Nigeri, Pakistan, Peru, Filipine, Koreja e Jugut, Mbretëria e Bashkuar (me përjashtim të Irlandës së Veriut) territoret e varura prej saj dhe Vietnam. Personat e lindur në Hong Kong SAR, Makau SAR dhe Tajvan janë të ligjshëm. Nuk ka ndryshime këtë vit nga viti i kaluar fiskal", thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

### KRITERET E PRANIMIT

Individët të lindur në një vend, vendasit e të cilit kualifikohen për të aplikuar për programin e lotarisë, mund të jenë të pranueshëm për të aplikuar. "Nëse nuk keni lindur në një vend të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë, nëse po, ju mund të deklaroni vendin e lindjes së bashkëshortit/ës në regjistrimin për lotarinë- me kushtin që emri juaj dhe i bashkëshortit/ës të jetë i renditur në aplikimin e përgjigdhur, t'ju lëshohet viza, dhe të hyni në SHBA në të njëjtën kohë. A keni lindur në një shtet,

### APLIKIMI

Udhëzimet e Lotarisë DV-2020 gjenden te faqja e ambasadës dhe te [travel.state.gov](http://travel.state.gov). Pas leximit me kujdes të udhëzimeve, aplikantët mund të plotësojnë dhe të dorëzojnë aplikimin e tyre. "Regjistrimet kryhen nga data 3 tetor 2018 ora 18.00 deri më datë 6 nëntor 2018, ora 18:00. Aplikimet mund të kryhen online tek [dvlottery.state.gov](http://dvlottery.state.gov)", thuhet në njoftimin e ambasadës.

vendasit e të cilit nuk janë të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë, por asnjëri nga prindërit tuaj s'ka lindur, apo s'ka qenë rezident i ligjshëm atje në kohën kur ju keni lindur, nëse po, ju mund të deklaroni si vendlindje një nga vendlindjet e prindërve tuaj, nëse ky vend është vend i kualifikueshëm për programin e DV-2020", thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

Çdo aplikant duhet të plotësojë ose kërkesën e arsimit ose kërkesën e përvojës së punës të programit të lotarisë, duke poseduar një arsimim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij, përkufizuar si përfundim me sukses i 12 viteve edukim të plotë zyrtar 9-vjeçar dhe i mesëm; ose të ketë dy vjet përvojë pune brenda pesë viteve të

### DV-2020

Programi i Vizave Emigruese të Shumëllojshmërisë, i autorizuar nga Kongresi, administrohet nga Departamenti i Shtetit në bazë vjetore. Seksioni 203(c) i Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë (INA) mundëson viza për një grup "emigrantësh të shumëllojshmërisë", prej vendeve me shkallë historikisht të ulët emigrimi në Shtetet e Bashkuara.

nuk do të pranohen e ligji lejon vetëm një regjistrim për çdo person gjatë periudhës së regjistrimit. Sipas udhëzimeve të ambasadës amerikane, të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të jetojnë në Shtetet e Bashkuara, duhet të ndjekin me kujdes 6 hapat për të vijuar me procesin e aplikimit. Kandidatët së pari, duhet të lexojnë udhëzimet. Udhëzimet e Lotarisë DV-2020 gjenden te faqja e ambasadës dhe te [travel.state.gov](http://travel.state.gov). Pas leximit me kujdes të udhëzimeve, aplikantët mund të plotësojnë dhe të dorëzojnë aplikimin e tyre. "Regjistrimet kryhen nga data 3 tetor 2018 ora 18.00 deri më datë 6 nëntor 2018, ora 18:00. Aplikimet mund të kryhen online tek [dvlottery.state.gov](http://dvlottery.state.gov)", thuhet në njoftimin e ambasadës. Ndërkohë kandidatët duhet të bëjnë shumë kujdes pasi aplikimet e shumfishta skualifikohen dhe të ruajnë numrin e konfirmimit. "Sigurohuni që të ruani numrin tuaj të konfirmimit që morët në përfundim të aplikimit tuaj dhe mos ia jepni askujt", thekson ambasada. Më tej kjo e fundit i bën thirrje aplikantëve që të kontrollonin nëse janë përzgjedhur, duke filluar nga data 7 maj 2019 e për këtë duhet të përdorin numrin e tyre të konfirmimit për të zbuluar nëse janë të Kontrollit i Statusit të të Regjistruarve. "Nëse keni rezultuar i përzgjedhur, ju duhet të ndiqni udhëzimet të Kontrollit i Statusit të të Regjistruarve që gjendet te [dvselectee.state.gov](http://dvselectee.state.gov). Udhëzimi në vazhdim është që të plotësoni formularin DS-260. Individët e përzgjedhur, të cilët ndjekin udhëzimet të Kontrollit i Statusit të të Regjistruarve, do të marrin njoftim rreth datës së takimit për vizë vetëm nëpërmjet kontrollit të Statusit të të Regjistruarve. Tarifa e vizës imigruese do të paguhet vetëm te Konsullata në ditën e intervistës suaj. Kjo është e vetmja tarifa që qeveria e Shteteve të Bashkuara mbledh nga programi i vizave të Lotarisë"-nënvizon më tej ambasada amerikane në njoftimin e saj.

## Jeremiç: Korrigjimi i kufijve shkëndijë për konflikt në Ballkan

### Ish- ministri thirrje ndërkombëtarëve: Parandaloni ndryshimin e vijave etnike

Ditën e djeshme, kryetari i Partisë Popullore, Vuk Jeremiç, në hapjen e "Global Forum Pearson" që u mbajt në Universitetin e Çikagos, komentoi idenë e korrigjimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë, dhe se çfarë do të sillte kjo për Ballkanin. Ai tha se korrigjimi në bazë të vijave etnike në Kosovë do të mund të jetë shkëndija e një konflikti të ri në Ballkan, dhe i bëri thirrje ndërkombëtarëve ta parandalonin një gjë të



#### VUK JEREMIÇ:

"Është e sigurt se një precedent i tillë shkaktoi një zinxhir të ngjarjeve. Korrigjimi i kufijve mund të jetë shkëndija që nisë konflikte të reja në Ballkan," tha Jeremiç.

tillë, transmeton lajmi.net. Jeremiç, i cili është ish-ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, tha se Beogradi dhe Prishtina janë të inkurajuar ta arrijnë një marrëveshje përmes korrigjimit të kufijve. "Është e sigurt se një precedent i tillë shkaktoi një zinxhir të ngjarjeve. Korrigjimi i kufijve mund të jetë shkëndija që nis konflikte të reja në Ballkan," tha ai. Jeremiç vlerësoi se demokracia në Ballkan po përkeqësohet nga indiferenca e Europës.

Ministri italian kundër rikthimit të charterave nga Gjermania

## Mateo Salvini: Do mbyllim aeroportet për azilantët

*Blllokuan portet tani hyrjet ajrore, Italia kundër refugjatëve*

Çështja e azilkerkuesve do të mbetet sërisht një patate e nxehtë për ministrin italian Salvini. Pikërisht ditën e djeshme, zv/kryeministri italian njëherësh ministër i Brendshëm reagoi ashpër ndaj informacioneve të ardhura nga Berlina se 2 avionë charter të mbushur me azilkerkues të dëbuar nga territori gjerman do të kthehen në Itali më datat 11 e 19 tetor. "Nëse dikush në Berlin apo Bruksel mendon se do të shkarkojë në Itali dhjetëra emigrantë me fluturime të pa autorizuar, duhet të dinë se asnjë aeroport italian do të jetë i disponueshëm. Do të mbyllim të gjithë aeroportet, ashtu siç kemi mbyllur portet", shkruan Salvini në rrjetet sociale 'Twitter' e 'Facebook'. Mbërritja e charterit të parë me 40 emigrantë të dëbuar nga Gjermania drejt aeroportit Fiumicino të Romës, është parashikuar më datë 11 tetor, informojnë mediat italiane. Me gjithë jo konfirmimet nga Ministria e Brendshme italiane, sipas mediave qeveria gjermane ka marrë vendimin e ky fakt ka shkaktuar dje reagimin e fortë të ministrit Salvini. Ndërkohë që më parë qeveria e Italisë miratoi një dekret që e bën më të lehtë dëbimin e migrantëve. Migrantët do të mund të dëbohen nëse gjenden fajtorë për krime serioze, të tilla si përdhunimi dhe sulmi. Më herët, kjo ka qenë e mundur vetëm në fund të një procesi të gjatë të apelit. Ministri i Brendshëm i Italisë,



Mateo Salvini

#### MATEO SALVINI

Brukseli mendon se do të shkarkojë në Itali dhjetëra emigrantë me fluturime të pa autorizuar, duhet të dinë se asnjë aeroport italian do të jetë i disponueshëm. Do të mbyllim të gjithë aeroportet, ashtu siç kemi mbyllur portet", shkruan Salvini në rrjetet sociale 'Twitter' e 'Facebook'.

Matteo Salvini, tha se masa e re është "një hap përpara drejt të bërit të Italisë vend më të sigurt". Dekreti duhet të miratohet edhe nga ligjvënësit. Ai po

#### MATEO SALVINI:

"Nëse dikush në Berlin apo Bruksel mendon se do të shkarkojë në Itali dhjetëra emigrantë me fluturime të pa autorizuar, duhet të dinë se asnjë aeroport italian do të jetë i disponueshëm. Do të mbyllim të gjithë aeroportet, ashtu siç kemi mbyllur portet", shkruan Salvini.

ashtu parasheh që azilkerkuesve të akuzuar për trafik droge, t'u refuzohen kërkesat, tha Salvini. Italia është destinacioni kryesor për migrantë që duan të arrijnë Evropën nga Afrika e Veriut. Qeveria e re populiste në Romë ka marrë prej kohësh qëndrim të ashpër ndaj tyre. Nga ana tjetër, më herët, në një intervistë për revistën prestigjioze amerikane, "Time", ministri Salvini ka thënë: "Jemi duke punuar për të rimarrë frymën evropiane që është tradhtuar nga ata që e drejtojnë këtë bashkësi" - tha Salvini mes rreshtave të interv-

istën dhënë në "Time" që do të publikohet e plotë më 24 shtator. Për sa i përket emigrimit, Salvini nënvizon se "historia do të na besojë rolin e shpëtimtarit të vlerave Evropiane", duke cituar "rrënjët hebreo-kristiane, të drejtën për të punuar, të drejtën për jetën". Dhe për sa i përket lidhjes mes emigracionit dhe kriminalitetit, Salvini i bie shkurt: "Nëse arrijmë të reduktojmë numrin e krimeve dhe praninë e emigrantëve të paligjshëm, mund të më quajnë racist sa herë të duan", - u shpreh ministri italian.

#### SHKURT

**New York, dasma  
kthehet në tragjedi, 20  
të vdekur**

20 persona kanë vdekur pas një përplasje të tmerrshme të limuzinës në New York ditën e djeshme. Dy automjete u përfshinë në aksident, i cili ndodhi pak para orës 14:00 (me orën vendase) në kryqëzimin e Rrugës Shtetërore 30 dhe Rrugës Shtetërore 30A. Zyrtarët lokalë thanë se limuzina po ngjiste një kodër dhe u rrëzua në rrethinat përpara dyqanit të Apple Barrel në Schoharie. Në limuzinën e stilit SUV thuhet se po bëhej një festë rrugës për në dasmë kur ajo u përplas me makinën tjetër. Tetëmbëdhjetë nga viktimat ishin në limuzinë dhe dy ishin në makinën tjetër, sipas Associated Press. Bridesy Finnegan, i cili jetonte në afërsi të zonës së rrëzimit, tha se dëgjoji një zhurmë të madhe kur dy automjetet u përplasën përpara Apple Barrel, një dyqan shumë i populluar me turistë. Zyra e Sherifit të Qarkut Schoharie, policia e shtetit e Nju Jorkut dhe ekuipazhet e emergjencës nga Kryqi i Kuq iu përgjigjën të gjitha vendit. Gjashtë ambulanca, tri kompani zjarri dhe dy helikopterë ishin në vendin e aksidentit, sipas Bashkimit Albany Times. Dëshmitarët, gjithashtu, panë njerëz që vrapuan nga kafja e Apple Barrel për të ndihmuar pas aksidentit. Përplasia ndodhi gjatë fundjavës ku, sipas banorëve të zonës, është dita më e madhe e turizmit të vitit për qytetin e vogël.

**Tërmet në Haiti,  
të paktën 11 të  
vdekur**

Të paktën 11 persona kanë vdekur dhe dhjetëra të tjerë kanë mbetur të plagosur nga një tërmet që goditi veriun e Haitit, në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Tërmeti i magnitudës 5.9 ishte një nga më të fuqishmit që goditi vendin e Karaibeve që nga lëkundja e madhe në vitin 2010, 7.1 ballë, e cila vrau më shumë se mijë persona shkruan Tg.com. Autoritetet lokale kanë raportuar për shembje dhe dëme të ndërtesave në disa qytete në pjesës veriore të vendit. Ndërkohë presidenti Jovenel Moïse u ka bërë thirrje njerëzve të qëndrojnë të qetë. Zëdhënësi i qeverisë Eddy Jackson Alexis tha se një "task force" për reagimin ndaj fatkeqësisë ishte ngritur. Studimi gjeologjik tha se epiqendra e tërmetit që goditi Haitin ishte rreth 19 km (12 milje) në veri-perëndim të qytetit Port-de-Paix.



Opinion i Ditës

# SHBA-Kinë vetëm luftë tregtare?

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

...janë pjesë integrale e evoluimit të rendit botëror, pavarësisht çështjes nëse do të shkohet drejt një ndryshimi të madh të tij apo në se kanë të drejtë ata që besojnë në një fund të rendit botëror liberal. Disa drejtime të këtyre zhvillimeve janë në proces evolucioni, ku ecuria e ndryshimit të marrëdhënies perëndimore dhe ajo e marrëdhënies mes SHBA, Kinës e Rusisë veçanërisht, por, dhe e aktorëve të tjerë të rëndësishëm, problemi i raportit mes multilateralizmit e globalizimit, por sidomos dhe ai i angazhimit dhe rolit të SHBA në zhvillimet botërore, sa i përket garantimit të stabilitetit e sigurisë së rendit botëror, tërheqin veçanërisht vëmendjen. Brenda kësaj përmbajtjeje të pasur dhe shumë të rëndësishme, po zhvillohet dhe ajo që është vlerësuar si një luftë e vërtetë tregtare mes SHBA dhe Kinës, që përfaqësojnë dy ekonomitë më të mëdha në botë dhe në kushtet kur globalizimi ka pasuruar ndjeshëm përmbajtjen e vet dhe ka evoluar cilësisht. Nëse nuk ndalesh vetëm përpara luftës reale tregtare, por depërton më thellë atëherë, do të kuptohet një problematikë komplekse, që afekton jo thjesht zhvillimet ekonomike e tregtare botërore, por dhe elementët e tjerë, nëse mban parasysh vendin e rolin e këtyre fuqive të mëdha në zhvillimet e sotme dhe të ardhshme botërore.

Një luftë tregtare mes tyre tashmë ka krijuar një përmbajtje konkrete. Ajo filloi me tarifën e deklaruarë të SHBA ndaj Kinës, që u shoqërua me kundër tarifën kinëze e më pas me tarifën e reja amerikane. Tash mund të flitet për një përshkallëzim serioz të kësaj lufte tregtare mes dy ekonomive më të mëdha në botë. Nëse SHBA vendosën tarifën në vlerën e 200 miliardë dollarëve ndaj produkteve kinëze, me argumentin se Kina ka ndjekur praktikën të padrejtë tregtare, Kina u përgjigj duke sanksionuar mallra amerikane në vlerën e 60 miliardë dollarëve. Marrë në tërësi, tarifën e vendosura nga SHBA kanë prekur produktet kinëze në vlerën e 250 miliardë dollarëve, që do të thotë, se gjysma e importeve të Kinës në SHBA, janë tashmë subjekt i këtyre tarifave. Këtë përshkallëzim të luftës tregtare SHBA e argumenton me synimin, që të ndalojë, atë që e kualifikon apo akuzon Kinën, për transferime të padrejta të teknologjisë dhe pronave intelektuale amerikane drejt Kinës. SHBA, me këtë lëvizje synon, gjithashtu, të mbrojë vendet e saj të punës, por, që kështu, nuk mund të mos shkaktojë tronditje në tregjet botërore, në kushtet e një ekonomie botërore tashmë të globalizuar. Kina u përpoq të lëvizte drejt sigurimit të bashkëpunimit edhe vendit të BE, të cilat përjetuan tarifa amerikane ndaj çelikut e aluminit, duke mbajtur parasysh edhe shkallën e globalizimit të ekonomisë botërore, por, që nuk arriti ta kurorëzojë. U fol në fillim të reagimit edhe evropian, për një samit të mundshëm BE-Kinë, por që nuk funksionoi. Në këto kushte të zhvillimit të luftës tregtare, rreziku i dëmtimit të ekuilibrave ekonomikë e tregtarë, bëhet më i lartë, kur merr parasysh edhe shqetësimet apo parashikimet e specialistëve të ekonomisë, për shpërthimin e një fluske të re, që mund të sjellë një krizë hibride, më të rëndë se ajo e vitit 2008.



Globalizimi, me përmasat që ka marrë, ka në përmbajtjen e tij edhe pozitiven por edhe negativin. Nëse do të ishte vetëm ose kryesisht negativ, ky fenomen nuk do të kishte të ardhme e nuk do të pasuronte përmbajtjen e tij, që tashmë rregullohet edhe nga organizma ndërkombëtare përkatëse, ku OBT ka një rol të veçantë. Tash, po flitet më shumë për fenomenet negative, ku përfshihet edhe mendimi se hiperglobalizimi ka thelluar ndjeshëm pabarazitë. Në kushtet e një konkurrence korrekte, kuptohet edhe prezenca e pabarazisë, por në se ato bëhen jashtëzakonisht të thella, atëherë vërtet përbën shqetësim real kompleks. Që ekonomia botërore është nën tension sot, kjo situatë nuk mund të shpjegohet kryesisht apo vetëm me përmasat e globalizimit. Nuk mund të mos llogaritet goditja e rëndë që dha kriza ekonomike e botërore financiare e vitit 2008, që u vlerësua si një lloj depresion i madh, por përmbajtja e pabarazive krijohet e ushqehet nga shkaqe shumë komplekse. Dhe ka realisht një problematikë sot që lidhet me taksat doganore, apo me borxhet e mëdha të akumuluar, me pabarazitë e mëdha sociale brenda vendeve sovraane, por dhe me çekullibrat e brendshëm në vende konkrete etj.

Pra, ka shumë arsye e faktorë, që duhen vlerësuar; analizuar e korrigjuar apo përsosur e nuk i duhet faturoar gjithçka globalizimit. Në këto kushte, as kundërvënja ndaj globalizimit, as mbyllja nën peshën e vizioneve nacionaliste e sovraniste, as një intensifikim i luftës tregtare, por as edhe një lënie drejt një rënie të lirë, nuk janë zgjidhje efektive. Në këto momente merr rëndësi të veçantë jo lufta tregtare, apo jo thjesht lufta, po para së gjithash merr rëndësi të qëndruesit të bashkuar; për të vlerësuar drejt situatën dhe gjetur rrugën më të përshtatshme të një reagimi efektiv dhe në

emër të një stabiliteti cilësor të rendit botëror. Një problem shumë i rëndësishëm aktualisht, që nuk mund të zgjidhet me luftë tregtare, apo me vërë tarifën e vërë kundërtarifën unë, është ruajtja e ekuilibrave ekonomikë, financiarë e sociale, si në nivel rajonal e në nivel botëror, kur janë krijuar hendeqe të thella pabarazie zhvillimi e gropa të mëdha të rrezikshme, me potencial të madh destabilizimi. Po kështu, një problematikë sociale, që përfshin një mprehje të ndjeshme të problemit të papunësisë dhe të thellimit të hendeqeve të pabarazisë sociale, brenda vendeve, por dhe në nivel global, një rritje e ndjeshme e varfërisë, përbëjnë bomba të rrezikshme për stabilitetin, sigurinë e paqen. Brenda kësaj situatë komplekse rrezik të madh apo bombë reale me mundësi shpërthimi, përbën problem i borxhit apo i borxheve, apo mbajtja nën kontroll i tyre. Nuk janë zgjidhje ato lëvizje, siç bëjnë vende të caktuara, që planifikojnë buxhete, me nivele të larta të deficitit, kur realisht kanë nivel të lartë të borxhit. Në këto kushte "lufta tregtare" edhe pse mendohet si zgjidhje nuk është e tillë për asnjë palë, përkundrazi dëmon rëndë edhe ato ekuilibra që funksionojnë. Po bëhet tepër e mprehtë nevojja e një strategjie komplekse, që të shqyrtojë harmonizimin e problemeve ekonomike, financiare, tregtare, teknologjike, sociale, organizative etj., aq më tepër që ka shqetësim reale për shpërthim të një krize tjetër ekonomike botërore, më e rëndë se ajo e vitit 2008.

Pra, siç shihet, ka një kontradiktë reale në zhvillim, mes dy ekonomive më të mëdha në botë, që përmban rreziqe të mëdha, nëse lufta tregtare nuk ndërpritet. SHBA dhe Kina nevojitet të dialogojnë e jo të tregtojnë dukuritë e fuqisë. Luftë do të thotë që mikujt të fitojë e të mundë tjetrin, por në këtë rast lufta prodhon problematika të

rënda për secilin dhe në shkallë botërore. Vërtet modeli kinëz i qëndroi mirë tronditjes që shkaktoi kriza botërore e vitit 2008, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk dëmtohet rëndë nga një luftë reale tregtare me SHBA. Modeli kinëz është një formë eklektike edhe me elemente të ekonomisë së tregut, edhe me kontroll shtetëror të rreptë edhe me një parti komuniste në udhëheqje të vendit. Ky model përfshin edhe tregun privat, por përfshin edhe mbajtjen nga shteti nën kontroll të monedhës së vendit, duke ruajtur pronësinë e kompanive të mëdha, por edhe duke ndërhyrë në vendimet e investimeve të bizneseve private. Mbështetur në këtë realitet presidenti kinëz Xi Ping, evidenton atë që e quan "vlerat kinëze", që sipas tij përfaqëson një opsion të ri për vende që dëshirojnë të përshpejtojnë zhvillimet e tyre, duke ruajtur pavarësinë. Me këtë model funksionues Kina është ekonomia e dytë më e madhe në botë sot, që ka shtyrë disa të flasin për "paradoksin kinëz". Filozofia nga është udhëhequr Kina ka qenë: zhvillimi është e vetmja e vërtetë. Natyrisht, që zhvillimi është i tillë, por përvojat historike të modeleve eklektike, apo siç ishte modeli komunist, me planifikimin e tij të centralizuar nën drejtimin e shtetit, dëshmojnë se, në periudha afat shkurtra këto modele tregojnë se funksionojnë, por më pas dështojnë dhe sjellin pasojë të kompleksë, siç u panë dhe në vendet ish-komuniste të lindjes. Nuk mund të mos tërheqin vëmendje sot tezat nacionaliste e sovraniste të mbylljes apo ato që drejtohen kundër globalizimit. Madje disa nisur edhe nga problematika komplekse e sotme, nxitojnë të flasin për atë që e quajnë "miti fals i ekonomisë së tregut". Në fakt, problemet e evidentuara sot nuk e vënë në pikëpyetje vlerën e modelit të ekonomisë së tregut, me gjithë nevojën e përsosjes së tij të mëtejshme, në gjithë elementët përberës së tij ekonomikë e sociale. Sa i përket modelit kinëz ai shfaqet interesant e funksionues, por që nevojitet kohë më e gjatë për të bërë një vlerësim realist e sa më afër të vërtetës.

Lufta tregtare në proces është një faktor negativ, pavarësisht modelit ekonomik. Ajo është pjesë esenciale e kontradiktës në zhvillim mes SHBA dhe Kinës, por që nuk është e vetmja. Kontradikta mes këtyre dy vendeve është më e pasur: Kina është tregtar shumë e kujdesshme me perëndimin dhe sidomos me SHBA, edhe pse përgatitje në proces për një rivalitet me përmbajtje të pasur me të. Tash ndodhemi realisht në një proces të ashpërsimit të këtij rivaliteti, që përfshin një përplasje interesash më komplekse e konkrete në zhvillim. Është fakt, që Kina edhe pse me shumë kujdes ka zhvilluar ambicën e saj të superfuqisë e të zhvillimit të rolit botëror, duke u shfaqur me një identitet të spikatur të saj, por shpesh edhe në një bashkëpunim konkret me Rusinë, përfshijë dhe fushën ushtarake. Ajo ka aderuar në organizmin euro aziatik ushtarak të Rusisë CSTO, por ka qenë e kujdesshme në avancimin e objekti-vave gjeostrategjike të superfuqisë. Ajo e ka siguruar një rol të saj në Azi, por ka hedhur dhe hapa konkretë të saj edhe për një rol në Paqësor, sido-

mos edhe me ato ishujt artificialë, tashmë të militarizuar prej saj dhe duke qenë e kujdesshme në zhvillimin e rolit të saj në gadishullin korean, duke shpresuar pse jo edhe në një zvogëlim të rolit të SHBA në të. Kina është kujdesur, si pa u vënë re, të risë praninë e saj në hapësirën europiane me investime konkrete si në infrastrukturë etj. Madje, Kina duket që shpresoi shumë të grindja mes SHBA dhe BE, duke e menduar edhe në një tërheqje të vendeve të BE në krahu të saj, sidomos sa i përket zhvillimeve ekonomike e tregtare. Kina, me sa duket, shpresoi se do të afroonte rreth vetes vendet e BE duke mbajtur parasysh zhvillimet e G7 edhe faktin e vendosjes së tarifave ndaj vendeve europiane për çelikon e alumini. Duket, që në funksion të avancimit të ambicës së saj të superfuqisë dhe të thellimit të rivalitetit me SHBA, Kina gjykoj të bëjë një demonstrim të muskujve, të saj, jo më vete e jo në hapësirën e Paqësorit, por më larg saj, në Siberi. Me sa duket, si Rusia ashtu dhe Kina e menduan ta demonstrojnë fuqinë ushtarake, në situatën kur vërtet po dukej një çarje e madhe dhe e pakthyeshme e Perëndimit, me grindjen mes SHBA dhe BE, apo në kushtet kur përflitet shpesh për një tërheqje nga SHBA, sa i përket rolit global të saj.

SHBA, nuk mund të mos e ketë vlerësuar qartë sjelljen kinëz dhe afishimet e përleshkëta ushtarake Rusi-Kinë. SHBA edhe pse aleatët e saj në Paqësor kanë shprehur shqetësimet e kundërshtimet e tyre ndaj lëvizjeve të Kinës me ishujt artificialë e militarizimin e tyre, që kështu kanë zgjeruar prezencën e Kinës në hapësirën e Paqësorit, janë treguar të kujdesshëm. Natyrisht, që SHBA ka mbështetur shqetësimet e reagimet e aleatëve të saj në Paqësor, por nuk ka bërë ndonjë demonstrim të fuqisë së saj. Ajo ka bërë lëvizje në funksion të mbajtjes hapur të korridoreve ujore të transportit në hapësirën e Paqësorit. Duket, që SHBA ka menduar të reagojë, që lëvizjeve të Kinës, përfshijë dhe pjesëmarrjen në stërvitjen tërë të madhe në Siberi, bashkë me Rusinë, që ishte një zhvillim i zmadhuar i forcës ushtarake. Kështu, mësohet se një anije ushtarake shkatërruese amerikane ka lundruar drejt ishujve të Kinës në pjesën jugore. Më pas avionë B-52 të SHBA fluturojnë në një hapësirë, ku Kina e ka shpallur si kufi të saj, por që SHBA lëvizjen në ujërat strategjike, ku operojnë disa vende aziatike si Kina, Japonia, Vietnami, Filipinet etj. Është ky një korridor rrugor i rëndësishëm, ku realizohet një tregti e qarkullim mallrash në nivelin e 5 trilionëve. SHBA e kanë shpjeguar këtë lëvizje të saj, jo si demonstrim të fuqisë ushtarake, por në formën: Ne bëjmë navigim të lirë siç kemi bërë edhe në të kaluarin dhe do të vazhdojmë të bëjmë të ardhmen. Gjithsesi, ky zhvillim nuk mund të mos tërheqë vëmendjen, aq më tepër, kur është në zhvillim edhe një luftë reale tregtare. Ky zhvillim i kontradiktës, mes SHBA dhe Kinës, shkakton shqetësim sa i përket ruajtjes së ekuilibrave dhe stabilitetit të zhvillimeve rajonale e globale.

Më 7 tetor 2018

Opinion i Ditës

# Cilat ishin ato, gratë e shkrimtarëve dhe artistëve?

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

...më tepër për gratë e të ikurve që nuk jetojnë më, por dhe në shenjë respekti për gratë e heshtura të shkrimtareve që jetojnë...Për shkrimtarët dhe artistët është shkruar dhe është folur shumë, por askush nuk i ka përmendur ato "të heshturat gjer në dhimbje, të thjeshtat gjer në madhësi" të cilat kanë qëndruar në jetë përkrah tyre dhe kanë përjetuar së bashku me ta sukseset dhe shqetësimet e kohës.

Poetët u kanë kushtuar poezi të dashurave të tyre, por askush nuk ka shkruar për ato, gra të heshtura dhe fisnike. më bukur se çdo shprehje përcaktuese ATYRE do t'u shkonin vargjet e Kadaresë "Ato të urtat gjer në dhimbje, të thjeshtat gjer në madhësi". Të tilla ishin dhe të tilla kanë mbetur në kujtesën time, të gjitha gratë e shkrimtarëve dhe artistëve që kam patur fatin të njoh. Të tilla ishin, të gjitha ato bashkëshorte të jetës së shkrimtarëve dhe artistëve të cilat më kanë pritur me buzëqeshje në familjet e tyre e më kanë përcjellë me dashuri vëllazërore. Të parat gra shkrimtarësh që kam njohur kanë qenë Helena e I.Kadaresë, dhe Sadija e D.Agolli, me të cilat më ra fati të kalojmë së bashku, katër vjet në një kurs, në bankat e Fakultetit Histori-Filologji. Të tilla e kam njohur Helena Kadarenë, fisnike e sjellsme dhe bujare, shkrimtare e afirmuar qysh në bankat të fakultetit, e të tillë ishte dhe shoqja tjetër e kursit, Sadie Agolli. E të tillë ishte bashkëshortja e poetit të shquar dhe profesorit tim, Fatos Arapi. E të tillë ishte Dhurata, bashkëshortja e mikut tim të paharruar Jakov Xoxes, e të tillë ishte Myneveri e shoqja e Dhimitër Shuteriqit, e të tillë ishte fisnikja e Lazar Siliqit. Të gjitha këto gra dhe të tjera, që nuk më bien tani në mend, ishin të thjeshta, të qeta, të dashura, të heshtura dhe të vërteta. Fillimisht kur punoja në Berat si arsimtar, pas mbarimit të fakultetit, pata fatin të njoh bashkëshorten e Fatmir Gjatës, Besa Morina...një grua e qeshur, e heshtur, rrezatonte mirësi dhe dashuri...Pas dënimt që pësoi Fatmiri në ato vite, ishte ajo që do ta vuante dënimin e bashkëshortit duke punuar në bujqësi, së bashku me kooperativistet e Lapardhaës, pa e ngritur kokën, duke ia ngritur kokën Fatmir Gjatës e duke nderuar veten e vet dhe të shoqin. Tani mendoj se shumë nga shkrimtarët që kam njohur kanë pasur fat që kanë pasur gra të tilla, pa të cilat nuk mund të kuptohet as sukseset i tyre as krijimtaria e tyre, as kuraja e tyre për shkrimtari. Gjatë viteve kur unë kam pasur fatin të punoj në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të jem midis shkrimtarëve të njohur si: Dhimitër Shuteriqi, Lazar Siliqi,



Sterjo Spase, Kolë Jakova, Petro Marko, Shefqet Musaraj etj., kam pasur fatin të njihem nga afër me gratë e tyre dhe me hallet e shqetësimet e tyre. Kujtoj me nderim Sterjovicën e Sterjos, e cila na priste me aq përkujdesje, mua dhe time shoqe, e na përcillte si qemoti, gjer jashtë portës, së bashku me Sterjon, sikur të ishim persona të rëndësishëm. Unë atëherë isha një letrar i ri, i porsamartuar, por zakoni, dashuria dhe mikpritja e tyre ishte e tillë që emociononte dhe gurët. Kujtoj me nderim bashkëshortet e Kolë Jakovës dhe Dhimitër Xhuvanit, të thjeshta dhe të heshtura të komunikimit me të gjithë. Tani që po shkruaj këto radhë ndjej krenari, por dhe një detyrim të vonuar për Sterjovicën, për Safon e Petro Markos, piktoreshen e njohur, grua e emancipuar, e cila na priste dhe na përcillte me kaq dashuri e me kaq fjalë të ëmbla. Kujtoj me respekt të thellë Myneveren, një intelektuale e klasit të parë, ish-partizane, e cila edhe pse punonte në detyra të rëndësishme shtetërore, ishte aq e thjeshtë dhe aq e sinqertë në bisedat tona. Të tilla ishin dhe gratë e artistëve që kam njohur gjatë viteve kur punoja me kolektivin e Operës dhe Baletit. Kujtoj me dashuri dhe nostalgji dy gratë ruse, Tatjanën, të shoqen e Pjetër Gacit dhe Ninën e Avni Mules, të cilat lanë vendin e tyre dhe erdhën, "në vendin e shqipeve", dhe të diktatorit më të egër, duke e paguar shtrenjtë dashurinë për bashkëshortët shqiptarë. Tani sjell në përfytyrim dhe

shumë gra të tjera, të miqve të mi, Marien e M. Vyskës, Nervanën e F. Halitit, Dhorkën e Dh. Orgockës. Ka qenë një kohë e vështirë. Kohë talonesh. Si të gjithë qytetarët e tjerë dhe shkrimtarët dhe artistët i gjeje në radhë, për një pako gjalpë, për një kile mish, për një shishe qumësht, për një pako oriz e një pako makarona, një kile mish në muaj, një kile djathë në javë. Nga koha kur kam punuar me Teatrën Popullor, por dhe në atë të Operës dhe Baletit, kujtoj me respekt të thellë shumë gra artistësh, si gratë e Agim Krajkës, Anitën e Agim Prodanit, shoqen e Cesk Zadesë dhe Tish Daisë, por më me respekt do kujtoj bashkëshorten e Naim Frashërit dhe të Kadri Roshit. Të dy artistët të shquar, gratë e të cilëve ishin model i këngëtarëve që punonin në korin e Operës. Nuk e mbanin veten si gratë e dy artistëve të mëdhenj. Me kujtohet dhe shoqja e Fatos Arapit, financiere me profesion. E qetë, e heshtur e pa bujë. Gjithë trazimet artistike të poetit të madh i bluante në heshtje. Kam shumë kujtime për këto gra të paharruara e tani që ato nuk jetojnë më kap një trishtim. Petro Marko nuk e hiqte cigaren nga buza. Hallet e Petros nuk kishin të sosur. Merr e hiq e drejta e botimit. Herë me punë herë pa punë. Po Petrus si Petrus. Nuk e uli kurrë kokën. Nuk e shteri kurrë frymëzimin, nuk e humbi kurrë kurajën. Stoik. Madhështor. Më madhështor dhe se krijimtaria e tij që na ka lënë dhe askush nuk kujtohet për të. Por më madhështore e më kurajoze qën-

dronde Safoja, e cila në çdo hall e çdo fatkeqësi, dhe kur i ra Jamarbri në burg, dhe kur nuk kishin para gjithmonë buzagaze. Po pse, pak andralla kanë pasur dhe Ismaili e Dritëroi? Edhe pse shkrimtarë të nderuar e të respektuar, kanë kaluar dhe ata, së bashku me gratë e tyre, net pa gjumë, për shkak të krijimtarisë së tyre, e cila u vëzhgohej me lenten zmadhuese të vigjilencës partiake. Po pas tyre ishin Helena dhe Sadia, me të cilat ndanim shqetësimet e kohës. Fatos Arapi ishte prej natyre impulsiv, ishte bashkëshortja e tij që shuannte në heshtje thëngjijtë e ndezur të zemërimit të tij poetik. I kujtoj sot me nostalgji dhe me respekt të veçantë të gjitha ato gra të heshtura, bashkëshorte të denja të shkrimtarëve dhe artistëve të mëdhenj, ndaj, duke shkruar për to, s' bëmë gjë tjetër veç, shpreh një obligim, i cili me ka munduar në vligim, për të treguar se ishin shkrimtarët poetët, kompozitorët, piktorët, aktorët, këngëtarët, që i dhanë aq shumë këting populli por, ishin dhe bashkëshortet e tyre të cilat ndanë shtratin dhe jetën me ta. Këto gra heroina kanë qenë edhe muzat e vërteta të krijimtarisë së tyre. Shkrimtarët dhe artistët kanë nevojë për dashuri dhe vlerësim. Ishin këto gra bujare që ua kanë dhënë me bollëk këtë dashuri. Ato ishin lexueset e para të librave të tyre dhe kritiket e rrepta të krijimtarisë. Tani që disa prej tyre nuk jetojnë më, s'na mbetet çfarë të themi veç t'i kujtojmë me respekt dhe krenari emrat e tyre.

## HOROSKOPI

### DASHI

Në dashuri duhet të mbështeten në intuitën e tij. Një investim i shkuar mund të rezultojë fitimprurës. Në punë mund të rrethohen nga dashamirësia e kolegëve që ju ofrojnë ndihmë.

### DEMI

Në punë mund të përballeni me disa pengesa artificiale. Kur je shumë i aftë, mbështetja nga kolegët zbehët. Në dashuri, yjet ju favorizojnë për një lidhje të re e cila mund të rezultojë e qëndrueshme.

### BINJAKET

Shumë prej të lindurve të kësaj shenje do të takojnë partnerin e ëndrave. Eshhtë në dorën tuaj nëse do të arrini ta mbani dhe ta ruani këtë marrëdhënie. Në punë mund të merrni një promovim.

### GAFORJA

Në dashuri veproni siç ju thotë zemra. Por në punë jo gjithçka është me ngjyra. Nëse tregoni vendosmëri do të arrini të dini edhe më i fortë. Injoroni komentet negative që vijin drejt jush.

### LUANI

Jeni shenjë shumë e fortë, por, gjithashtu, e mbushur me dashuri. Kjo mund të keqkuptohet. Tregojani vendin njerëzve që nuk dinë t'ju vlerësojnë. Dikush në punë ju sheh me shumë zili.

### VIRGJERESHA

Një ditë e mbarë për të lindurit në shenjën tuaj. Yjet ju favorizojnë në familje, në punë dhe në dashuri. Shfrytëzoni këtë shans për të nisur një biznes që mund t'ju sjellë të ardhura.

### PESHORJA

Nëse jeni duke kërkur një punë, favorizoheni për të aplikuar. Edhe nëse intervistoheni, yjet do t'ju favorizojnë. Por në dashuri mund të lindë një problem ose një krisje besimi në çift.

### AKREPI

Nëse jeni duke kërkur një punë, favorizoheni për të aplikuar. Edhe nëse intervistoheni, yjet do t'ju favorizojnë. Por në dashuri mund të lindë një problem ose një krisje besimi në çift.

### SHIGJETARI

Mos u jepni rëndësi fjalëve negative që vijin nga persona për të cilët nuk gëzoni ndonjë konsideratë. Negativiteti është bërë pjesë e pandashme nga disa njerëz. Karma do t'i godasë ata.

### BRICJAPI

Nëse në kokë keni një projekt, përpicuni ta realizoni sa më shpejt. Në sfond duken shumë para, por mënyrat për t'i marrë ato janë shumë të pakta. Krijoni aleanca më njëzë inteligjentë.

### UJORI

Jeni duke menduar për t'u zhvendosur. Ndiheni i lodhur nga njerëzit që keni përreth veçanërisht në vendin e punës. Mos ndërmerrni asnjë hap nëse jeni i zemëruar. Mund ta fusni veten në telashe.

### PESHQIT

Ditë me fat për personat e dashuruar. Një keqkuptim në çift do të zgjidhet duke e bërë raportin tuaj më të fortë. Zgjidhjet që të merrni një shpëtim të më në punë, duke shikuar xhezi tek të tjerët.



Shënon Xhixha për bardhezinjtë, Blazhevski humbet penallti. Ze Maria nuk del në konferencë

# Laçi si 'Hulku i Pamposhtur', fiton edhe me Tiranën

## Kurbinasit mbeten ekipi i vetëm pa humbje



Jeton Selimi

**L**açi thyen Tiranën dhe kap Partizanin e vendit të dytë (mortalisht kryeson Skënderbeu, të kuqtë luajnë ndeshjen e tyre sot kundër Kukësit), duke treguar edhe njëherë se janë një kundërshtar i frikshëm për këdo, një skuadër që ka ndryshuar fizionominë e saj duke shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme sparkat si brenda fushe ashtu edhe jashtë saj. Laçi i Mërgjyshit nuk i druhet askujt dhe ndonëse presidenti Laska e ndonjë lojtar e çon nëpër mend fjalën titull, trajneri i kurbinasve preferon të qëndrojë me këmbë në tokë. Natyrisht kjo Tiranë nuk është skuadra më e fortë e kampionatit, por t'i marrësh një trepikësh në shtëpi është vërtet një arritje.

Sidomos pasi ke pësuar fillimisht presionin e skuadrës bardheblu e më pas të rrisësh lojën për ta konkretizuar me gol, atë gol të minutës së 50-të, kur Fangaj gjen në zonë Xhixhën e pamarkuar, me këtë të fundit që gjuan rreptë dhe saktë duke thyer Likën. Më herët kishte një protestë të bardhebluve për një 11 metërsh, por



#WEARETIRONA

### KONSTATIMI

Laçi i Mërgjyshit nuk i druhet askujt dhe ndonëse presidenti Laska e ndonjë lojtar e çon nëpër mend fjalën titull, trajneri i kurbinasve preferon të qëndrojë me këmbë në tokë. Natyrisht kjo Tiranë nuk është skuadra më e fortë e kampionatit, por t'i marrësh një trepikësh në shtëpi është vërtet një arritje.

kryesori Hamitaj ndëshkon Blazhevskin për simullim. I njëjti Blazhevski që kishte

në këmbët e tij golin e barazimit, por penalltinë e akorduar nga Hamitaj për

prekje të topit me dorë në zonë, e gjuan jashtë. Pak përpara se maqedonasi të vinte topin të pika e bardhë, pati një debat të ndezur me Ngoo se cili prej tyre duhej ta ekezkutonte atë. Shiu i dendur e bën edhe më dramatike mbrëmjen e kryeqytetasve, që në këtë përballje janë braktisur dhe nga tifozët e tyre. Të paktën mbështetësit në shkallët e "Selman Stërmasit", ndërsa një ultrasit kishin shpallur edhe njëherë banderolën "Largohuni" për të ndenjtur pasivë në pjesën e

parë, ndërsa në të dytën nisën mbështetjen.

Të Laçi i gëzohen fitores, e katërta në tetë javë kampionat, ndërsa kurbinasit kanë shënuar dhe po katër barazime për një total prej 16 pikësh, ende të pamposhtur, "Hulku" i kampionatit, që forcën e tij e shfaq dhe në kryeqytet duke nxjerrë zbuluar të gjithë brishtësinë e Tiranës, me ekipin e Ze Marias që nuk arriti ta mbajë arnën e qepur në Fushë-Krujë ndaj Kastriotit, por u rifut në krizë.

### TRAJNERI I LAÇIT

Mërgjyshi: Ende nuk jemi gati për titullin kampion

**M**jaft entuziasht pas fitores në fushën e Tiranës, trajneri i Laçit, Artan Mërgjyshi, theksoi pas ndeshjes se skuadra e tij po kalon një moment të mirë dhe këtë e vërteton me të gjithë elementët e mirë që shfaq në fushë. Trajneri i Laçit ka komentuar edhe rastin e penalltisë së Tiranës: "Është e vërtetë që është me shumë vlera kjo fitore, jo vetëm për klasifikimin, por edhe mënyrën si po luajmë. Jemi në një moment të mirë, pavarësisht se kundërshtari që bëri mirë në fragmente të caktuara të lojës. Ne nuk mund të themi ende se jemi për titull, jemi ekip i ri, që konsolidohet javë pas javë, di të vuajë në momente të caktuara, pro të shfrytëzojmë momentin, duke parë ndeshjen e radhës. Po shfrytëzojmë gjendjen e mirë që po kalon Shtubina, po shfrytëzojmë maksimalisht çfarë kemi në dispozicion këto janë mundësitë. Penalltia? Nuk do të merrem fare me gjyqtarët. Unë jam nga ato që kam vuajtur shumë nga gjyqtarët, tani kam vendosur të mos flas. Nuk e kuptoj se çfarë është 11-metërshi i Ngo, i cili i ka duart e hapura. Rasti i Blazhevskit? Nuk ka tentuar të vazhdojë vrapimin, ka kërkuar kontakt dhe mendoj se gjyqtari ka vepruar drejt".

SUPERLIGA		
<b>TE DIELEN</b>		
Luftëtari - Skënderbeu	0-2	
Kamza - Flamurtari	2-2	
Tirana - Laçi	0-1	
Teuta - Kastrioti	2-0	
<b>TE HENEN</b>		
Kukësi - Partizani	13:45	
<b>RENDITJA</b>		
Skuadra	N	P
Skënderbeu	8	17
Partizani	7	16
Laçi	8	16
Kukësi	7	13
Flamurtari	8	11
Teuta	8	11
Tirana	8	8
Kamza	8	7
Luftëtari	8	6
Kastrioti	8	4

### TË TJERAT

**S**kënderbeu nuk di të ndalet, duke marrë edhe fitoren e radhës, këtë herë, korçarët kanë mundur me rezultatin 0-2 Luftëtarin në transfertë, duke bërë edhe një paraqitje fantastike. Të besuarit e Shehit, kanë pasur disa mundësi të mira për të shënuar në pjesën e parë, por që Gripshi, Bregu e Krasniqi nuk arritën të shënonin. Ka qenë i sapofuturi në lojë, Arditi Hoxhaj ai i cili në minutën e 67 ka shënuar golin e avantazhit, ndërkohe që në minutën e 80, ka qenë radha e Bruno Dites që ka shënuar golin e dytë dhe të fitores për korçarët. Me këtë fitore, Skënderbeu ngjitet në vendin e parë me 17 pikë, 1 më shumë se Partizani që luan sot ndeshjen

### Skënderbeu merr vendin e parë, Teuta mposht Kastriotin, paqe në Kamzë

e tij. Ndërkohë, Luftëtari mbetet në kuotën e 6 pikëve. Kamza dhe Flamurtari kanë ndarë nga një pikë në barazimin spektakolar 2-2. Ka qenë një duel shumë i luftuar, por edhe i barabartë mes ekipeve, të cilat kanë kërkuar me ngulm të bëjnë lojë sulmuese. Kamza kaloi shpejt në avantazh me Plakun, por pak nga pak, Flamurtari u zgjua dhe arriti të përmbyste gjithçka me anë të Bushiç e Mustës. Gjithsesi, Kamza u zgjua në minutat e fundit dhe meritë mori një barazim pasi rrezikoi disa herë portën e

Koliçit, shpesh vendimtar me pritjet e tij. Ka përfunduar me rezultatin 2-0 ndeshja mes Teutës dhe Kastriotit. Të dy golat janë shënuar nga sulmuesi Amadu Latif, i pari me penalltinë e fituar nga Bicaj dhe i dyti pas një gabimi të mbrojtjes krutane dhe portierit Puja. Golat e kanë bërë gjithçka të lehtë për Teutën, që më pas e ka administruar me qetësi ndeshjen. Me këtë fitore, durrskakt janë më të qetë dhe ndërprerjen e kampionatit do të përpignta shfrytëzojnë për të korrigjuar gabimet.

### Braziliani nuk paraqitet në konferencën për shtyp

### Sherr dhe tone të larta, Ze Maria nxiton të ikë nga stadiumi



lojtarët në disa momente. Sipas "SuperSport", trajneri më pas ka dalë dhe u ka komunikuar drejtuesve të Tiranës që nuk do të dilte në konferencën e zakonshme për mediat apo në ekranin e televizionit. "I leave" (unë largohem), ishin fjalët e vetme të tij, por nuk dihet ende nëse i referohej dorëheqjes nga bardheblutë, apo nëse bënte fjalë vetëm faktin që po dilte nga dera e stadiumit, siç ndodhi.

lojtarët në disa momente. Sipas "SuperSport", trajneri më pas ka dalë dhe u ka komunikuar drejtuesve të Tiranës që nuk do të dilte në konferencën e zakonshme për mediat apo në ekranin e televizionit. "I leave" (unë largohem), ishin fjalët e vetme të tij, por nuk dihet ende nëse i referohej dorëheqjes nga bardheblutë, apo nëse bënte fjalë vetëm faktin që po dilte nga dera e stadiumit, siç ndodhi.

Trajneri kuqezi kërkon fitoren si ndaj Jordanisë në miqësore, ashtu edhe ndaj Izraelit

# Panuçi: Sulmin e orkestroj dikush që ndikon te lojtarët!



Jeton Selimi

*Italiani snobon edhe njëherë Kategorinë Superiore*

**K**ristian Panuçi ka bërë fasuar të gjithë ndër sa ditën e djeshme ka rezervuar një konferencë shtypi të palajmëruar më parë nga Federata Shqiptare e Futbollit, madje as e përfshirë në programin javor të publikuar më herët. Përpara gazetareve, trajneri italian ka dhënë versionin e tij për mosgrumbullimin e Abazajt apo edhe mospërfshirjen e lojtarëve të superiores në listën e tij, të cilët italianit i snobon dukshëm. Ai ndjehet i sigurt në krye të stollit kuqezi dhe këmbëngul se gjëja e parë që do të bëjë me lojtarët, është të kuptojë sesa e vlerësojnë ata fanellën kuqezi.

**Ka ndodhur diçka për këtë konferencë të jashtëzakonshme?**

Jo, është thjesht konferenca përpara grumbullimit. Thjesht e vendosa në minutat e fundit, për ta zhvilluar para fillimit të grumbullimit.

**Nëse ka ndonjë neglizhencë për kampionatin shqiptar, me qenë se janë duke u luajtur ndeshjet?**

Për sa i përket lojtarëve që janë, kam informacionet e duhura. Vij i shikoj.

**Thirrja e Uzunit dhe Gavazajt, disa muaj pas largimit nga Kategoria Superiore...**

Nëse ka pak që vijnë në Kombëtare nga kampionati, do thotë se ka pak. Nëse vjen ndonjë lojtar, më sinjalizohet nga Bulku. Ai vëzhgon gjithçka, nëse ka ndonjë interesant, unë vij të shoh meqë drejtoj Shqipërinë. Uzuni është lojtar që luan prej 5 ndeshjesh të Lokomotiva, është një lojtar, i cili ka karakteristika të ndryshme nga ata që kemi në ekip. Gavazaj po luan pak, dje hyri në minutën e 90. Në Europë ka pak shqiptarë që luajnë, në Shqipëri vitin e kaluar ishte Guri, e mbledha. Kur ka lojtarë interesantë e thërras, nëse ka ndonjë që bie në sy kur shkon jashtë, shkoj ta shoh.

**Për deklaratën e Abazajt në "Panorama Sport" që të gjithë janë interesuar, përveç Panuçit...**

Ka 4 muaj që nuk luan. Pse duhet të vijë në Kombëtare? Këtu jërzëzimet mëdoj që është post pune. Jam takuar me të dhe më ka shprehur që stërvitet shumë të Anderlehti, e nuk ia del dot më. Ka shumë sforcim dhe lodhet shumë. Në Ligën e Europës nuk është as në 23-shën. Unë



moment, ai që është në shënjestër është Panuçin. Për mua ekipi Kombëtar është maksimalja. Ne nuk kemi lojtarë që luajnë në gjysmë-finalet e Championsit. Nuk kemi as Brazili as Franca. Duhet të më dëshmojnë seriozitet disa prej lojtarëve. Rini të qetë. E respektoj shumë Shqipërinë.

**A keni menduar diçka për të përmirësuar mbrojtjen?**

Pësoj gola. Jam duke menduar realisht për ketë gjë. Kam konstatuar që kur kemi në avantazh, skuadra pëson më pak. Do të shoh kondicionin e Mavrajt. Kam një sasi lojtarësh në mesfushë, por më duhet të shikoj mbrojtjen. Me Skocinë pësuam një gol nga kornia që mund ta evitonim. Duhet më tepër zemër. Fitoam një ndeshje dhe barazuar me Maqedoninë. Lopetegui na përçollti komplimentet përkatëse. Me Italinë e ulën pa ritmin. Me Norvegjinë kishim 6 mungesa dhe pësuam gol nga goditja e këndit. Duhet të shikoj këtë probleme. Ndaj Ukrainës dhe Kosovës na mungonin 11 lojtarë. Të shohim se çfarë na rezervon shorti i Europianit.

**Është shumë e vështirë të zgjedhësh një kapiten?**

Më duhet ta demonstrojnë në fushë, nëse dikush prej tyre e ka realisht peshën e një lideri. Kam dëgjuar se Panuçi është diktator dhe nuk i lejon lojtarët të qeshin. Për sa i përket pjesës time, për çështjen e kapitenit më duhet ta demonstrojnë. Më pas do ta vendos unë dhe pse jo...

**Sjellja me ekipin...**

Krahu im i djathtë janë Kaseti dhe Bulku. Mavraj është lojtar me personalitet, ne kemi folur shumë bashkë në Zvicër dhe ai është i rëndësishëm. Zgjedhja është, se nëse një ditë më kërkohet, dua që djemtë të më duan. Dëgjoj të thuhet edhe që ankohe se nuk luajnë këtu, por nuk luajnë në kombëtare. E di se mund të jenë persona jashtë ekipit që merren me lojtarët e i organizojnë. Nuk jam budalla dhe i kuptoj. Siç i referohem të gjithë asaj që ndodhi pas ndeshjes me Skocinë. Telefonon Berishën pse nuk luan Strakosha e Strakoshën se pse nuk luan Berisha. Imagino të bëhem si Luis Enrique, që u bëh çelularin në mëngjes, do vdisnin nga infarkti se nuk do të

futeshin në "Instagram". Unë mendoj se i bëj të ndihen mirë lojtarët.

**A varet e ardhmja në 3 ndeshjet e radhës?**

Duhet të pyesni Dukën. Jo, unë jam shumë i lumtur që drejtoj Shqipërinë. Por kam nevojë të shkoj me të gjithë në luftë. Nëse presidenti vendos që problemi është Panuçi, atëherë ik. Unë e lashë futbollin me 2 vite kontratë e u largova nga Palermo. Duhet vlerësuar puna, pastaj nëse Panuçi ka një fat dhe fiton një 0-3, mund të shkojmë në Europian. Unë fle i qetë, se mëdoj 24 orë në 24 për Shqipërinë, asgjë tjetër. Nuk ka asgjë për profesionalizmin tim. Mund të gaboj, por të gjithë përmirësohen. Nëse mendon ndryshime për fazën mbrojtëse Nëse na bën gol menjëherë kundërshtari, bëhëj e vështirë edhe me Izraelin, se bëjnë gabime me atë ndeshje. Na eci mirë se Izraeli ka cilësi, me Skocinë vuajtëm dhe sapa u bëra me 3 mbrojtës, pësuam gol menjëherë. Nëse shënonte Balaj, do ndryshonte gjithçka, e më pas e pësuam me këndore. MekGini na mori në shkëlma të gjithëve, por asnjë nga ne nuk e bëri këtë, nuk reagoi. Ne e mbajtëm gojën mbyllur. Po nuk dhamë gjithçka, edhe me Murinjto, Guardiola, Bulku apo Çarçanin vazhdon e njëjta gjë. Jam i bindur se këta lojtarë mund të bëjnë shumë më tepër, ne me këta 23 mund të shkojmë në Izrael e fitojmë. Me këtë skuadër mund të shkojmë e fitojmë atje. Pastaj të shohim me Sadikun e Roshin të rikuperuar ku mund të shkojmë.

**Përse ndryshimet funksionuan kundër Izraelit, ndërsa kundër Skocisë nuk funksionuan. A është momenti i duhur për t'i provuar kundër Jordanisë?**

Është pikërisht kjo ndeshje me Skocinë që më bëri të mëdoj dhe do pyesë skuadrën çfarë është për ta Kombëtarja. Nëse do të kish të shënuar Balaj do të ndryshonte loja. Ishin pa zjarr lojtarët. Lojtari i Skocisë thuaje i goditi. Nuk dua të fshihem. Më këta 23 lojtarë, jam i bindur që mund të japin shumë. Mund të shkojmë në Izrael dhe mund t'ia dalim. Me rikuperimin e Sadikut, Roshit edhe të tjerëve, skuadra mund të kompletohet.

## TRAJNERI I KOMBETARES

**H**Ka një muaj që ndodhem në shtëpi dhe mëdoj për asgjë tjetër veç futbollit Nuk e kam kuptuar ende nëse një pjesë e lojtarëve e kanë kuptuar se çfarë është ekipi kombëtar i futbollit. Është diçka që do ua kërkoj djemve: çfarë është për ju ekipi kombëtar?

Pasi nëse fitohet në rregull, nëse humbet gjithashtu, nuk është në rregull. Ne po humbim mundësinë e Europianit.

mërzitem se nuk e shoh as në pankinë atje, ndërsa ai mërzitet se nuk e grumbullova. Nëse është mërzitur, të përveshë mëngët e të lodhë b....

**Po për lojtarët që kanë pak minuta?**

Ka një muaj që ndodhem në shtëpi dhe mëdoj për asgjë tjetër veç futbollit Nuk e kam kuptuar ende nëse një pjesë e lojtarëve e kanë kuptuar se çfarë është ekipi kombëtar i futbollit. Është diçka që do ua kërkoj djemve: çfarë është për ju ekipi kombëtar? Pasi nëse fitohet në rregull, nëse humbet gjithashtu, nuk është në rregull. Ne po humbim mundësinë e Europianit. Nëse fitojmë ndaj Izraelit, jemi 2 ndeshje larg Europianit. Dua të kuptoj se çfarë është kombëtarja për ndonjë lojtar. Kemi 5 ditë për të përgatitur ndeshjen. Nëse kam gabim, çdo dorën. Nga ndeshja me Norvegjinë na mungojnë 45% e lojtarëve. Hiqi pak

lojtarët më të mirë Barcelonës e flasim. Nuk kam pjesën më të madhe të lojtarëve që atëherë duhet të bëj diçka për të shkuar në Europian. Nuk po flas për Kosovën e Ukrainën që na mungonin 12 lojtarë. Tani rikuperojmë Mavrajn që nuk luan prej shumë muajsh, rikuperojmë Grezden që t'i japim minuta me Jordaninë, por duhet të ndryshoj diçka, në mënyrën se si shkojmë te goli. Duhet të luajnë minuta Mavraj, Gjimshti, Grezda, Binaku duhet të luajnë, sepse kur jam në shtëpi të shtunën e të dielën, jo shumë luajnë. Nuk di nëse luan edhe Hysaj sot. Kam nevojë t'u jap minuta këtyre. Nëse luajnë 45 minuta apo 60, pastaj të shohim, në mënyrë që të aktivizoj ekipin që kam në kokë ndaj Izraelit. Por, ekipi në Izrael do të jetë i fortë, të shohim se rikuperojmë Mavrajn, një lojtar i rëndësishëm për ne. **Mund të jetë ndeshja ndaj**

**Izraelit një "finale" e vogël për Shqipërinë?**


Nuk e kam kuptuar ende që një pjesë e lojtarëve arrijnë ta kuptojnë se çfarë është ekipi i futbollit. Pres një përgjigje në ndeshjen ndaj Izraelit. Kur fitojnë ok shumë mirë. Kur humbasin ok shumë mirë. Duhet të tentojmë të luajmë në Europian. Jemi shumë afër Europianit. Do t'i pyes lojtarët se çfarë është për ata ekipi kombëtar. Për disa prej tyre, kuptohet. Kemi shumë lojtarë të dëmtuar që nuk luajnë ose nuk janë në formë. Në miqësoren ndaj Ukrainës dhe Kosovës që na mungonin 12 lojtarë. Kam një plan specifik. Kemi rikuperuar Mavrajn dhe Grezden, që nuk i ka minutat. Do t'ia japim këtë mundësi. Ne nuk kemi Brazili. Nuk kemi Nejmarin. Duhet patjetër të ndryshoj diçka nuk kam shumë kohë në dispozicion.

**A mos ndoshta më mirë që ta mendonim Jordaninë si provë gjeneralë?**

Është shumë e rëndësishme për mua, që t'iu jam minutat e duhura, lojtarëve që u mungojnë. Për këtë do ta shfrytëzoj edhe miqësore. Më rezultojnë shumë lojtarë që nuk luajnë. Do të jetë skuadër shumë e mbledhur ndaj Izraelit. Rikuperojmë Mavrajn që është një lojtar i rëndësishëm dhe me karakter. Më duhet të ma dëshmojnë disa prej lojtarëve se çfarë do të thotë të jesh në ekipin Kombëtar. Në çdo



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Dillon aktor.
5. Një listë që zgjidhet nga regjisori
9. Sigla e tritolit.
12. Kapitani që ndiqte balenën Moby Dick.
14. Eshhtë spektatori i yni.
16. Fillojnë lejen
17. Një sinjal akustik.
19. Një parashitesë për... përtej.
20. Eshhtë partia e Sali Berishës.
23. Kanë organizatën Hamas.
24. Gëlojnë nga murgjit.
25. Në teori kur mungon ti.
27. Inicialet e A.Gide.
28. Inicialet e Asimov.
29. Nisen pa ne.
31. Kreshniku i volejbollit.
36. Kufijtë e tokës.
37. Mund të jenë autonome të tilla.
38. Britma e Arkimedit.

41. Fillojnë vetëm.
42. Bota jashtë ëndrrës.
44. Mund të jenë ushtarakë.
46. Italia në Internet.
47. Gjysmë atomik.
49. Janë prova inteligjence
50. Një libër hartash.
51. Clapton i muzikës.

**VERTIKAL**

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një... bombë tenistike.
3. Fillojnë themelet.
4. Mund të jetë klasifikimi.
6. Një letër... kampioni.
7. Eshhtë pozicioni për gjumë.
8. Janë diktatorët despotikë.
9. Një kryeqytet afrikan.
10. Qe mesfushor i famshëm i Ajax.
11. Ekstreme në tenis.
13. Eshhtë e dendur në xhungël.
15. Eshhtë brinjë në skuadër.
18. Eshhtë pako që dërgohet.
20. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
21. Bëjnë taktika me taka.
22. Vetot pa kufij.
23. Persekutonin romakët.
24. Eshhtë gri ajo e trurit.
26. Një mund të jetë spiuinzi.
30. Janë vendet për nisje.
32. Me to bëjnë torta.
33. Janë katër në kitarë bas.
34. Institucione Urbane Rajonale.
35. Priten me lotë në sy.
39. Një rreth pa ekstreme.
40. Gjysmë kasate.
41. Eshhtë cilësia.
43. Ente Tregtare Lokale.
45. Një pjesë e territorit.
48. Në hyrje të oazit.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Jagger i Rolling Stones.
4. Zanore për kuaj.
6. Janë dhelpra.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Kufizojnë rastet.
14. Mbyllen me epilog.
16. Eshhtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
18. Gjysmë njeriu.
20. Janë fruta ekzotikë.
21. Një minierë e vjetër.
23. Ata tanë ishin ilirë.
24. Masat pa kufij.
25. Një gëzim i madh.
26. Agjenci Ndërmjetëse Përmët
27. Eshhtë godinë në miniaturë
29. Film i Ridley Scott
31. Duken të gjata në pritje.
32. Njëzetmije... në det në një libër të Jules Verne.

**VERTIKAL**


34. Eshhtë kreu i bandës.
36. Ndahen nga ortakët.
38. Eshhtë numri një.
41. Janë trupa qëllorë të tillë.
44. Kanë dhoma për t'u zënë.
46. Tri çupa në poker.
47. As unë, as ai.
48. Janë vitet.
49. Pak amatoriale.
1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Nuk e ulin kokën.
5. Këndohen në opera.
6. Janë tek në Somali
7. Eshhtë lloj papagalli.
8. Mbyllin komentin.
9. Eshhtë e parë për prodhim.
10. Kush ka do të pijë.
13. Janë binarë.
15. Rolet pa ret.
16. Vihen për të mbyllur të tilla.
17. Janë tek në mantel.
19. Salgari që krijoi Sandokan.
20. Një stinë e ngrohtë.
22. Janë pamje nga puna.
26. Një fjalë goxha.
27. Ato Eilliams janë teniste
28. Ishin të parët tanë.
29. Janë edhe ato polare.
30. Fillojnë nazet.
33. Inicialet e Triolet.
36. Një bëhet me pozë.
37. Mbyllin punimet.
39. Nodoh në kufij.
40. Perignon i champagne-s.
42. Eshhtë iks ajo e sulmit.
43. Enti europian i hapësirës.
45. Fillojnë lehtë.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		3		4					
2			3	6					
					9	2		4	
	5	4						8	
	7		8						
8							1	7	6
7		9			1	6			
4					7				
	3	5	2			9	1		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	3	8	4	6	9	5	7	1
6	9	1	3	5	7	4	2	8
7	4	5	8	1	2	3	9	6
9	1	3	5	7	8	2	6	4
8	5	6	9	2	4	7	1	3
4	7	2	1	3	6	8	5	9
3	8	7	2	9	1	6	4	5
5	2	9	6	4	3	1	8	7
1	6	4	7	8	5	9	3	2

*Argëtim filozofik*

- Nëse i mohan të vërtetën një femre, dije se ajo do të bëjë të besosh vërtetë gënjeshtrat e sajë
- Në varrimin e së vërtetës, gënjeshtra mbajti një fjalim prekës
- Nuk ka rëndësi se kush, mjafton që dikush të dëgjon me të vërtetë..!
- Mos lejo kurrë që zemra të vendosi 'presje' aty ku mendja është e sigurt që duhet vendosur 'pikë'
- Nëse e bën një femër të buzëqeshë, gjithmonë ke vend në zemrën e saj...

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

15	S	A	I	S	F	8		14	4		14		7	4	15
4	11	4				1	8	12	2	3	14	5			10
10			1	4	1	2	8	10	6	4	7	5			
4	7			1	7	5	8	9	4	2	10	4			
15	3	1				6	2	10	5	2	6				12
	7	1	11	13	5			1	5		17	15	1		
17	3	10	13	3			4	4		4	10	6	3		
4		2	4	7			11		6	10	4	2	4		
12	1	5	16	4	10	5		4	4	4	8	16			
14	4	7	4			8	14	5		17	3	10	10		
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5	4			
3	4	2	5			4	1	2	8	10	6		2		

R	A	S	T	E	T		P	A		P		
U	R	A	T		U		R	H	P	A		
S	A	M		M		M	A	R	A	I	S	
I		A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
		P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E
G	J	I	G	A	N	T	I		I	R	U	
B	E	T	O	N		E	K		B	O	R	
	S	A	L	I		R	A	M	A			
T	O	N			T	I	T	U	L	L	I	
A	R	E	S		A	O				E	R	
P	J		A	R		Z	O	T	I	M	I	
A	A		M	E	R	E	N	G	U	E	S	

- Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shqetësimin
- Nuk ka ilaç që mund të shërojë atë që nuk shëron dot lumturia...!!
- "Kurrë më!" -Thoshte vullneti i lodhur..
- "Edhe një herë.." -Lutej zemra duke rënuar..
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta
- Më pëlqente. Duke një tip interesant derisa filloi të flasë... Cfarë mallkimi!

*Thënie të mençura*

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

N	E	N	T	O	K	A	A	S	C	E		
T	R	U	P		T	A	L	E	N	T	E	S
O	R				P	A	N	T	E	R	A	T
K	E	L		K	A	N	D	I	L	E	T	
B	A	K	U	N	I	N	A	D	A	M		
T	A	M	A	R	O	C	O	O	A	K		
M	E	E	T	O	N	A	T		N	D	U	
A	R	I	T		L	I	Z	E	O	T	T	O
K	E	S	A		D	E	T	I		E	I	R
E	L	S	A		P	A	L		N	O		A
T	A	T		P	I	R	A	T	E	R	I	A
T	I	R	A	N	A		H		R		P	
O	R	A	R	I		B	T	E	A	T	E	R
R	O	M	A		K	A	B	I	R	B	E	D
T	N	A		B	A	R	I	T	O	N	I	L
U	I		R	A	M	B	O		I		L	
R	A	D	I		P	A	G	A	N	I	Z	M
A	V		E	R		A	L	A		I		
T	P	A	R	T	I	A	K		I	N	A	T
L	A	L	A		F	E	M	R	A		H	
P	E	L	I	K	A	N	I		T	H		E
M	I		J	A	S	O	N		I			
A	P	A	R	A	T	E			P	A		R

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**



